



Vlerësimi Institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri

**Raport i Vlerësimit Institucional të
Universitetit Evropian të Tiranës**

Shtator 2016



Mbështetur nga
Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë,
Mbretëria e Bashkuar

Përmbajtja

Rreth këtij vlerësimi.....	1
Konteksti i këtij vlerësimi	2
Raporti i përmbledhur	3
Përmbledhje e gjetjeve	4
Gjykimi i përmbledhur	6
Raporti i detajuar	7
Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij	7
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet	13
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula	18
Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi	24
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre	29

Rreth këtij vlerësimi

Ky vlerësim institucional ka për qëllim të përgjithshëm të kontrollojë dhe vlerësojë, për secilin prej IAL-ve, shkallën e përmbushjes së standardeve shtetërore shqiptare të cilësisë, të hyra në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi institucional i jashtëm është një proces këqyrje, kontrolli dhe vlerësimi nga ekspertë të jashtëm. Secili grup vlerësimi përbëhet nga ekspertë nga Mbretëria e Bashkuar, të përzgjedhur dhe caktuar nga Agjencia Britanike e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (QAA-UK), dhe ekspertë shqiptarë, të përzgjedhur dhe caktuar nga Agjencia Publike Shqiptare e Akreditimit për Arsimin e Lartë (APAAL). Grupi i Vlerësimi të Jashtëm drejtohet nga një ekspert i QAA-UK.

Raportet e përfundimtare do të shërbejnë jo vetëm për akreditimin institucional, në bazë të shkallës që IAL-ja përmbush standardet, por edhe për informimin e IAL-ve, Qeverisë Shqiptare, publikut dhe studentëve mbi shkallën që IAL-ja përmbush standardet. Ky raport ndihmon gjithashtu IAL-të të identifikojnë çështjet me përparësi për përmirësim (procesi përmes të cilit ofruesit e arsimit të lartë përmirësojnë sistematikisht cilësinë e shërbimit dhe mënyrat si ata i mbështetin studentët për të nxënë).

Standardet Shtetërore Shqiptare të Cilësisë janë grupuar në pesë fusha vlerësimi: Organizimi i institucionit dhe menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; si dhe studentët e mbështetja e tyre. Ky raport nxjerr në pah karakteristikat e praktikave të mira, jep rekomandime, konfirmon veprimet në proces dhe paraqet dobësitë për çdo fushë vlerësimi, së bashku me një gjykim se në çfarë shkalle IAL-ja përmbush standardet. Ekspertët mund të japin këto gjykime: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur në pjesën më të madhe; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk përmbushen.

Në fund, ekspertët dalim me një rekomandim, në formën e një gjykimi të përmbledhur, drejtuar Këshillit të Akreditimit të APAAL-it. Ky gjykim i përmbledhur mund të jetë një nga shkallët e më poshtme:

- **Standardet shtetërore të cilësisë janë përmbushur plotësisht**
- **Standardet shtetërore të cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet shtetërore të cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet shtetërore të cilësisë nuk janë përmbushur.**

Gjatë procesit të hartimit të raportit, QAA-UK ofroi ekspertizën e saj duke siguruar që grupi i ekspertëve të mbështesë konkluzionet e tij në evidenca. Gjithashtu ajo dha ndihmesën e saj duke redaktuar dhe hartuar përmbledhjen e raportit të plotë të dhënë më poshtë.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Profesor Mark Hunt
Dr. Janthia Taylor
Z. Stephen Harris
Dr. Diturije Ismaili

Kryetar
Anëtare
Anëtar
Anëtare

Konteksti i këtij vlerësimi

Universiteti Europian i Tiranës (UET) është një universitet privat fitimprurës në Tiranë, Shqipëri, i themeluar në vitin 2006. UET-ja u licencua nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës më 20 shtator 2006, me vendimit të Këshillit të Ministrave [Nr. 636/2006] dhe është i akredituar nga Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë.

Vizioni i Universitetit është të jetë lider në zhvillimin e dijes në shoqërinë shqiptare; një qendër ekselence në formimin akademik të studentëve të tij; një qendër e specializuar në fushën e studimeve shoqërore, politike, ekonomike dhe juridike në vend, me ndikim në rajon e më gjerë; si dhe një qendër ekselence për kërkimin shkencor në fushat e ekspertizës së Universitetit. Misioni i Universitetit është t'u ofrojë studentëve arsim cilësor, mbi bazën e rezultateve të kërkimit shkencor; t'i shërbejë shoqërisë shqiptare përmes krijimit dhe përhapjes së dijes, proceseve të mësimdhënies, kreativitetit, si dhe me anë të ndërveprimit me tregun e punës e bashkëpunimet ndërkombëtare. Vlerat e Universitetit përfshijnë: cilësi dhe ekselencë; lidhshmëri dhe punë në grup; liria e eksplorimit intelektual; drejtësia dhe integriteti; transparenca dhe përgjegjësi; dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës.

Universiteti ka tri fakultete: Fakulteti Juridik; Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit dhe Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Edukimit, tetë departamente dhe një qendër.

Universiteti ofron programe të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë në gjuhën shqipe dhe jep diploma të nivelit Bachelor, që zakonisht zgjasin 3 vjet. Gjithashtu jep edhe diploma të nivelit Master Profesional, që zgjasin 1-1.5 vjet, dhe të nivelit Master i Shkencave, që zgjasin 2 vjet. Në vitin 2011, Universiteti fitoi të drejtën e dhënies së gradave doktor në shkencat sociale, ekonomike dhe juridike. **[Vendim nr. 503]** Universiteti ofron 13 programe studimi Bachelor, 24 programe të studimeve Master dhe tre programe të studimeve doktoratë. Universiteti drejton shtëpinë botuese "UET Press" dhe boton pesë revista shkencore. Universiteti aktualisht ka 167 vetë të punësuar si staf akademik, prej të cilëve 80 janë profesorë me kohë të plotë dhe 87 profesorë me kohë të pjesshme, **[19 Prof. Dr, 24 Assoc. Prof Dr., 18 PhD, 20 Dr]** 82 lektorë dhe katër studiues. Në vitin 2015-2016, Universiteti kishte 4,149 studentë të regjistruar në programet me kohë të plotë. **[2361 cikli i parë, 1557 cikli dytë dhe 231 cikli i tretë]**

Universiteti synon të jetë një universitet lider, duke kontribuar në zhvillimin socio-ekonomik të Shqipërisë, duke ofruar arsim të një cilësie të lartë në shërbim të shoqërisë, ekonomisë, politikës dhe zhvillimit të qëndrueshëm afatgjatë. Çështja e ndërkombëtarizimit dhe lista e gjerë e organizatave partnere janë me përparësi për axhendën e universitetit, të cilat së bashku me kontributet e konsiderueshme të akademikëve evropianë dhe amerikanë, që marrin pjesë në konferencat dhe forumet e Universitetit, nxjerrin në pah vizionin e tij strategjik.

Raporti i përmbledhur

Një ekip i Universitetit, i përbërë nga stafi drejtues, ai akademik dhe ai mbështetës dhe një përfaqësues i studentëve, hartuan një raport vetëvlerësimi. Projektraportet iu shpërndanë një audiencë të gjerë brenda Universitetit, përpara se raporti të përfundohej dhe të miratohej nga Rektori dhe Grupi i Vetëvlerësimit.

Vizitat u zhvilluan gjatë dy ditëve. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga tre ekspertë të arsimit të lartë nga Mbretëria e Bashkuar dhe një anëtar me përvojë në arsimin e lartë nga një institucion shqiptar. Për të ndihmuar Grupin e Vlerësimit të Jashtëm, Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL) i vuri në dispozicion Menaxherin e Vlerësimit dhe një përgjegjës për të mbajtur shënime. Tetë javë përpara vizitës së vlerësimit, Grupit i Vlerësimit të Jashtëm mori raportin e vetëvlerësimit dhe portofolin e dokumenteve mbështetëse, që më pas u plotësuan nga dokumentacioni shtesë i kërkuar. Gjithsej morën në shqyrtim 134 dokumente, me anë të të cilave Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u njoh me strukturën, politikën, procedurat e menaxhimit dhe natyrën e aktivitetit mësimor dhe kërkues të ndërmarrë nga Universiteti. Dokumentet dëshmuese të marra në shqyrtim nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përfshinin Statutin e Universitetit, Rregulloret Akadematike, Raportet Vjetore, procedurat e pranimit dhe orientimit, gamën e marrëveshjeve me jashtë dhe shembuj të informacionit të programit dhe Dokumentet të mbledhjeve vendimmarrëse.

Gjatë vizitës dyditore të vlerësimit, u zhvilluan një sërë takimesh që i dhanë Grupit të Vlerësimit të Jashtëm mundësinë të kuptojë më qartë përgjegjësitë, procedurat dhe pikëpamjet e stafit dhe studentëve. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm zhvilloi takime me pronarin, presidentin, rektorin, drejtues të lartë, studentë, lektorë dhe personel administrativ e mbështetës. Gjatë të gjitha takimeve, u mbajtën procesverbale. Si pjesë e vizitës në kampus, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vizitoi bibliotekat, auditorët, laboratorët e TI-së, si dhe pa një demonstrim të sistemeve informuese online dhe elektronike të Universitetit të aksesueshme nga studentët dhe stafi. Pasi mori në shqyrtim të gjitha dokumentet e disponueshme, Grupi i vlerësimit të Jashtëm arriti në përfundimet e paraqitura më poshtë.

Universiteti i përmbush plotësisht standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e institucionit. Përgjegjësitë për organizimin dhe menaxhimin e Universitetit përcaktohen qartë në Statutin dhe Rregulloret e Universitetit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pa si praktikë të mirë krijimin e Bordeve të Tregut të Punës për secilin departament, për të garantuar që programet të jenë të përshtatshme dhe për të nxitur punësueshmërinë e studentëve, si dhe sasinë dhe cilësinë e bashkëpunimeve që Universiteti ka me universitete me reputacion jashtë Shqipërisë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë të dobësi dhe nuk dha ndonjë rekomandim. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi se Universiteti duhet të vazhdojë të mbajë një qëndrim proaktiv, për të siguruar që institucioni të jetë gati karshi kuadrit të ri ligjor.

Universiteti i përmbush plotësisht standardet për Burimet. Përgjegjësitë për burimet përcaktohen qartë në Statutin dhe Rregulloret e Universitetit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi si praktikë të mirë mbështetjen që i ofrohet stafit akademik për të kryer një kualifikim më të lartë në një universitet jashtë vendit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë të dobësi dhe nuk dha ndonjë rekomandim. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi zhvillimet e vazhdueshme që mbështesin burimet e Universitetit, duke përfshirë

zhvillimin e vazhdueshëm të sistemeve për menaxhimin e informacionit me qëllim sigurimin e informacionit strategjik dhe të integruar në lidhje me performancën e Universitetit.

Universiteti i përmbush plotësisht standardet për Kurrikulën. Misioni i Universitetit përqendrohet në një kurrikul mësimore e cila mbështetet në përparësitë rajonale dhe kombëtare të tregut të punës. Grupi i vlerësimit të Jashtëm e identifikoi si praktikë të mirë krijimin e Bordeve të Tregut të Punës dhe mësimin e gjuhës angleze për studentët e ciklit të parë dhe qasjen e diferencuar dhe gjithëpërfshirëse në mbështetje të studentëve, duke përfshirë kërkesat fillestare të programit, tutorialet, zhvillimin e karrierës, kujdesin për personat me aftësi të kufizuara dhe mbështetjen emocionale. Nuk u identifikuan dobësi dhe nuk u dhanë rekomandime. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon rritjen e rolit të ish-studentëve në Bordet e Tregut të Punës dhe në aktivitetet institucionale.

Universiteti i përmbushur plotësisht standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin. Përgjegjësitë për menaxhimin e Mësimdhënies, Mësimnxënies, Vlerësimit dhe Kërkimit janë përcaktuar qartë në Strategjinë e Kërkimit dhe Politikat e Kërkimit Shkencor të universitetit. **[Dokumente 6, Strategjia e Kërkimit 2011-2015; 60 Broshura e dokumenteve për Politikat e Kërkimit Shkencor]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm njohu dy aspekte të praktikës së mirë: angazhimin aktiv në marrëveshjet e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtare dhe partneritetet; dhe krijimin e shtëpisë botuese të vetë Universitetit, e cila publikon tekstet mësimore dhe kërkimet. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë dobësi dhe nuk bëri ndonjë rekomandim apo pohim.

Universiteti i përmbush kryesisht standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre. Përgjegjësitë për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përcaktuar qartë në Statutin dhe Rregulloret e Universitetit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi si praktikë të mirë qasjen e diferencuar dhe gjithëpërfshirëse të mbështetjes së studentëve, morinë e mbështetjes për punësimin e studentëve, sigurimin e një numri të madh bursash dhe përfaqësimin aktiv të zërit të studentëve brenda Universitetit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi si dobësi analizën e të dhënave të punësimit të të diplomuarve. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që Universiteti të zhvillojë një strategji dhe proces të qartë për mbledhjen e të dhënave të punësimit të të diplomuarve, për të mbështetur zhvillimin e programeve studimore të Universitetit dhe Shoqatës Alumni. Nuk u identifikua asgjë për t'u pohuar.

Përmbledhje e gjetjeve

Praktikë e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- krijimi i Bordeve të Tregut të Punës për secilin departament, për të garantuar që programet të jenë të përshtatshme, për rishikimin e kurrikulave mbi bazë vjetore dhe nxitjen e punësueshmërisë së studentëve (pika 1.12 dhe pika 3.1)
- angazhimi aktiv në marrëveshjet e bashkëpunimit kombëtare dhe ndërkombëtare me universitete me reputacion jashtë Shqipërisë (pika 1.13 dhe pika 4.6)
- mbështetja që i ofrohet stafit akademik, për të kryer një kualifikim më të lartë në një universitet jashtë vendit.

- përdorimi i Bordeve të Tregut të Punës të çdo departamenti, për të rishikuar kurrikulës në bazë vjetore, për të siguruar përshtatshmërinë e saj dhe për të shtuar mundësitë e punësimit të studentëve (pika 3.1)
- zhvillimi i strukturuar i mësimit në gjuhën angleze në kurset e ciklit të parë aftëson studentët të komunikojnë shumë mirë në gjuhën angleze dhe të kenë më shumë besim në mundësitë për mobilitet (pika 3.7)
- qasja e diferencuar dhe gjithëpërfshirëse në mbështetje të studentëve, duke përfshirë kërkesat fillestare të programit, tutorialet, zhvillimin e karrierës, kujdesin ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe mbështetjen emocionale (pika 3.10 & pika 5.5)
- mbështetja që iu ofrohet studentëve gjatë periudhë së praktikës profesionale, në kuadër të programeve të tyre të studimit (pika 4.1)
- krijimi i shtypit të vetë Universitetit, i cili publikon si tekstet mësimore, ashtu edhe kërkimet, duke rritur në këtë mënyrë përvojën e studentëve dhe të stafit mbështetës në shpërndarjen e rezultateve të kërkimit (pika 4.9)
- niveli i lartë dhe numri i madh i bursave në dispozicion të studentëve (pika 5.6)
- përfaqësimi i zërit të studentëve në jetën institucionale të Universitetit, përfshirë: përfaqësimin në komisione kyçe, pjesëmarrjen në këshillat studentorë, realizimin e anketimeve të studentëve dhe angazhimin në klube dhe shoqata (pika 5.11)
- dhënia e ndihmesës për të gjetur punësim për studentët, duke përfshirë stazhin, Panairin vjetor të punës, Forumin e Biznesit të Universitetit dhe udhëzimet për karrierën (pika 5.12).

Dobësi

- analiza e të dhënave të punësimit të të diplomuarve (pika 5.12).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- zhvillimi i një strategjie dhe procesi të qartë për mbledhjen e të dhënave të punësimit të të diplomuarve, për të mbështetur zhvillimin e programeve të studimit të Universitetit dhe të Shoqatës Alumni (pika 5.12).

Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet e ndërmarra si më poshtë:

- mbajtja e një qëndrimi proaktiv për të siguruar që institucioni të jetë gati karshi kuadrit të ri ligjor (pika 1.5)
- Universiteti të vazhdojë të zhvillojë sistemet e tij të menaxhimit të informacionit, për të siguruar informacion strategjik dhe të integruara për performancën e Universitetit (pika 2.15)
- rritja e rolit të ish-studentëve në Bordet e Tregut të Punës dhe në aktivitetet institucionale, mban lidhjet me ta dhe zhvillon bashkëpunime të reja me industrinë, duke ruajtur në këtë mënyrë angazhimin e tyre me Universitetin (pika 3.1).

Përmbledhje e gjykimeve për çdo Fushë Vlerësimi

- 1 Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur plotësisht.
- 2 Standardet për Burimet janë përmbushur plotësisht.
- 3 Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht.
- 4 Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur plotësisht.
- 5 Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur kryesisht.

Gjykimi i përmbledhur

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandon Këshillit të Akreditimit që Universiteti European i Tiranës i përmbush plotësisht standardet shtetërore të cilësisë.

Raporti i detajuar

Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

- 1.1 Universiteti Europian i Tiranës (JET) është një organizatë “fitimprurëse” dhe e kryen veprimtarinë e tij sipas legjislacionit shqiptar, **[Dokumente 1.1, Rregulloret]** përfshirë edhe strukturën organizative të Universitetit. Organet kryesore drejtuese të Universitetit janë Senati Akademik, Rektorati, Këshillat e Fakultetit, Këshilli i Etikës, Këshilli Drejtues i Shkollës së Doktoratës, Bordi i Shkollës së Studimeve Master, Bordi i Financimit të Aktiviteteve Kërkimore dhe Këshilli i Profesorëve. Gjithashtu janë përcaktuar edhe postet e larta drejtuese: Presidenti, Rektori, Zëvendës Rektori, Dekanët e Fakulteteve, Drejtorët e Shkollave të Doktoratës dhe Studimeve Master. Rregullorja përshkruan fakultetet e Universitetit, të cilat janë tre: Fakulteti Juridik, Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe Arsimit, dhe Fakulteti i Ekonomisë dhe i Teknologjisë së Informacionit. Ka dy shkolla, Shkolla e Doktoratës dhe Shkolla e Studimeve Master. Senati akademik, që kryesohet nga Rektori, është komiteti udhëheqës akademik dhe ndihmohet nga dy borde këshillimore, Bordi i Këshilltarëve, që drejtohet nga Presidenti dhe Asambleja e Ortakëve, që drejtohet nga Administratori. **[Kapitulli III Standardi I.1; Kapitulli III Standardi I.2]**
- 1.2 Bordi Akademik është autoriteti më i lartë për sa i takon vendimeve për çështjet akademike dhe shkencore, por për vendimet me pasoja strukturore ose financiare, kërkohet miratimi i Asamblesë së Ortakëve dhe ky organ përfaqësohet nga Administratori. **[E1.2 12.4]** Administratori drejton Bordi i Administrimit: ky organ nuk ka kompetenca për marrjen e vendimeve në lidhje me çështjet akademike, por shërben si një lidhje ndërmjet Senatit Akademik dhe organeve këshillimore, duke përfshirë Asamblesën e Ortakëve dhe Bordin. **[Mbledhja 1, Rektori, M4 Drejtuesit e nivelit të lartë, M8 Presidenti dhe Administratori]** **[Kapitulli III Standardi II.1]**
- 1.3 Diskutimet me Drejtuesit e nivelit të lartë, stafin akademik dhe studentët konfirmuan se struktura e Universitetit ka funksionuar mirë deri më sot dhe se Universiteti synon të zgjerojë strukturën e fakulteteve në vitet e ardhshme, gjë që do të kërkojë miratimin nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Universiteti ka ngritur grupe pune për këtë gjë. **[M1 Rektori, M4 Drejtuesit e nivelit të lartë, M8 Presidenti dhe Administratori, M2 1, studentë të ciklit të parë, M3, studentët e ciklit të dytë dhe të tretë, E2.2]** Organigrama e strukturës së Universitetit është e publikuar në faqen e internetit. **[E2.10]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon se Universiteti funksionon në përputhje me statutin e tij dhe është efikas në aspektin e menaxhimit të tij. **[Kapitulli III Standardi I.2]**
- 1.4 Rregulloret përcaktojnë **[Dokumente, kapitulli X, neni 43]** të drejtat dhe detyrimet e studentëve, përfshirë të drejtën për të marrë pjesë në qeverisjen e Universitetit, nëpërmjet Këshillit Studentor. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm zhvilloi diskutime me stafin e lartë drejtues dhe akademik, si dhe me studentë të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë në Universitet, gjë që konfirmoi se studentët marrin pjesë plotësisht në qeverisjen e Universitetit, duke marrë pjesë në mënyrë aktive në mbledhjet e komisioneve, duke filluar nga niveli i departamentit deri në Senatin Akademik, në të cilin janë tre përfaqësues të studentëve: Presidenti, Zëvendës-presidenti dhe

Sekretari i Përgjithshëm i Studentëve. Përfaqësues të studentëve edhe në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Universitet. Për Grupin e Vlerësimit të Jashtëm ishte ë qartë se Universiteti nxit debat konstruktiv. **[M2, M3, M4, Ref 8.16. në dokument shtesë AE 53] [Kapitulli III Standardi I.3]**

- 1.5 Gjatë kohës së vizitës së vlerësimit, në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit ishte paraqitur një projektstatut i ri, megjithëse ligji i ri për universitetet nuk ishte ende në fuqi dhe aktet nënligjore nuk janë miratuar ende. Statuti do të hartohet sërish kur ligji të hyjë në fuqi dhe aktet nënligjore të jenë publikuar. Universiteti mban një qëndrim proaktiv për të siguruar që institucioni të jetë gati karshi kuadrit të ri ligjor. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm çmon se kjo shkallë e parashikimit dhe planifikimit aktiv për të trajtuar ndryshimet në kuadrin ligjor meriton një **pohim. [Kapitulli III Standardi I.1]**
- 1.6 Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi se gjithë dokumentacioni i nevojshëm për komisionet, u shpërndahet anëtarëve me postë elektronike përpara mbledhjeve, për t'i dhënë shtysë debatit dhe vendimmarrjes. Senati Akademik mblidhet të paktën tre herë në vit dhe mund të thërrasë mbledhje të jashtëzakonshme kur është e nevojshme. Rektorati mblidhet çdo javë; po ashtu bëjnë edhe departamentet. Rektori organizon edhe një takim mujor me Këshillin Studentor. Ndërsa mbledhjet e departamenteve janë të përjavshme, në fund të çdo muaji organizohet një takim i hapur i departamentit, ku mund të marrin pjesë edhe studentët. Gjithashtu, çdo semestër mbahen takime jo formale dhe pa procesverbal me pjesëmarrjen e studentëve, për të mbledhur të dhëna cilësore për departamentet, në bazë të përvojës së studentëve. **[M2, M3, M4, M6, E2.3.b Raporti i Grupit të Fokosit]** Stafit dhe studentët konfirmuan rregullsinë dhe dobinë e mbledhjeve të komisioneve dhe që procesverbalet iu dërgohen më pas pjesëmarrësve. Studentët pohuan se ata marrin feedback për atë që është diskutuar, si edhe ndonjë përgjigje që Universiteti ka dhënë në lidhje me veprimet ose ndryshimet e propozuara. Sipas anketimit të studentëve nga APAAL-i, shumica e studentëve deklaruan se vendimmarrja e Universitetit është transparente. **[M2, M3, M4, E2.2, Anketimi i Studentëve fq.29, pyetja 21]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mbajti takime me stafin e lartë, stafin akademik dhe administrativ, nga ku konfirmoi se struktura vendimmarrëse funksionon mirë. **[M1, M4, M6]** Për të lehtësuar debatin konstruktiv në një mjedis të jashtëm, Universiteti organizon takime jashtë universitetit për të bërë diskutime të pa shqetësuar. Universiteti ka mbajtur organizime të tilla për mbarë institucionin gjatë një fundjave, gjatë së cilave stafi ka mundësinë të diskutojë zhvillimin e Universitetit. E para është mbajtur në vitin 2012 dhe një tjetër në vitin 2015. Organizimi i parë solli zhvillimin e Shkollës së Studimeve Master dhe të Shkollës së Doktoratës. **[M7, E3.7] [Kapitulli III Standardi I.3]**
- 1.7 Universiteti krijoi një njësi për sigurimin e cilësisë në vitin 2014, Komisionin për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (KSBC). KSBC-ja është një njësi e përhershme e organigramës së Universitetit dhe funksioni i saj përcaktohet në Rregulloret e Universitetit **[E2. Rregullorja UET, Neni 7]** dhe në Statutin e tij. **[E1. Statuti i UET-së, Neni 11: 11.1.2]** KSBC-ja siguron vlerësimin e cilësisë dhe garantimin e veprimtarisë akademike, administrative dhe financiare të Universitetit. KSBC-ja përbëhet nga një Kryetar dhe anëtarë, që përfaqësojnë secilin fakultet dhe stafin administrativ, si dhe një anëtar përfaqësues i Këshillit Studentor dhe së paku një

ekspert i jashtëm. **[E3.6 Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, E1.3. Broshura e dokumenteve F.VII. për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë]** KSBC-ja përgatit një raport vlerësimi për Dekanin e secilit fakultet, ku përfshin aktivitete akademike, si përgatitja e syllabusve, planifikimi i leksioneve dhe seminareve, kërkimi, planifikimi dhe organizimi i mbledhjeve të punës në nivel fakulteti dhe departamenti. **[E3.6]** Dy nga objektivat kryesore të tij janë krijimi i një kulture cilësore brenda Universitetit dhe monitorimi i nivelit të përfshirjes së studentëve në aktivitetet e përditshme të institucionit. Ndërkohë që Grupi i Vlerësimit të Jashtëm çmon faktin që Universiteti ka struktura të efektshme për mbikëqyrjen dhe vlerësimin e brendshëm, ai është i mendimit se proceset e kryera gjatë monitorimit vjetor nga KSBC-ja kryesisht matin pajtueshmërinë aktuale, dhe përkrah zhvillimeve të ardhshme të Universitetit, njësia mund të zhvillojë një qasje më të përqendruar në përmirësimin dhe zhvillimin e sigurimit të cilësisë. Megjithatë, Grupi vuri re se puna e KSBC-së vlerësohet nga stafi dhe ka rëndësi vendimtare për Universitetin. **[M4, M5, M6, M7, M8] Kapitulli III Standardi I.4] [ESG 1.1 Politika e sigurimit të cilësisë]**

- 1.8 Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi se stafi dhe studentët Universitetit përfitojnë nga lidhjet me institucionet evropiane të arsimit të lartë. Nga dokumentet e vëna në dispozicion të Grupit të Vlerësimit ishin memorandumet e mirëkuptimit me Universitetin e Uellsit të Jugut, në Mbretërinë e Bashkuar; Universitetin e Biznesit dhe Teknologjisë, Kosovë; Universitetin e Shkencave të Aplikuara të Hagës, Holandë; të gjitha këto marrëveshje janë ende në fuqi. Me Shkollën e Biznesit të Stokholmit, Suedi, ka marrëveshje shkëmbimi, dhe me Universitetin e Ludëigshafen, Gjermani, ka një marrëveshje ndër-institucionale në kuadër të programit Erasmus+. Të dyja këto marrëveshjet janë në fuqi. **[E3.2, 4.26]** Memorandumi mbulon shkëmbimet e studentëve, shkëmbimin e anëtarëve të fakultetit, projektet e përbashkëta kërkimore dhe konferencat e përbashkëta. Në rastin e Shkollës së Biznesit të Stokholmit, parashikohet zhvillimi i kurrikulave të përbashkëta dhe i diplomave të përbashkëta. Nga diskutimet me stafin dhe studentët, u vërtetua se marrëveshjet e mësipërme japin përfitime të qarta për të dyja grupet. **[M2, M3, M4, M5, M6, E1.14, 1.18, 1.19, 1.20, 1.22, 1.41, 1.42, 2.15, 4.26] Kapitulli III Standardi I.4]**
- 1.9 Nga viti i themelimit të Universitetit në vitin 2006 e deri më sot, kanë qenë tre plane strategjike: Plani i Zhvillimit 2006-2011, Plani i Zhvillimit me titull "UET si një Qendër ekselence, për periudhën 2011-2016" dhe Plani Strategjik aktual për periudhën 2016-2020. **[M8, E1.5, 2.4]** Plani i Zhvillimit 2011-2016 u hartua gjatë një takimi të veçantë me stafin në vitin 2011 dhe ai pohon vlera si: "pjesëmarrja e motivuar e studentëve, profesorëve dhe stafit administrativ në aktivitetet e Universitetit". **[E1.5 II.3]** Dokumenti i vitit 2011 përfshin një mjet për vlerësimin e pjesëmarrjes së studentëve dhe shumë tregues të performancës që mund të maten. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm kërkoi sqarime në lidhje me ecurinë e shënuar kundrejt disa prej këtyre treguesve, por nuk kishte asnjë dokument, ku të paraqitnin këto të dhëna. Andaj progresi i Planit të Zhvillimit 2011-2016 mbetet i paqartë. Universiteti është duke rivlerësuar pozicionin e tij. Plani Strategjik 2016-2020 përcakton përparësitë e rishikuara në lidhje me kërkimin shkencor, procesin mësimor (duke përfshirë përafrimin e mëtejshëm me Procesin e Bolonjës), studentët dhe jeta studentore, botimet dhe

materialet studimore akademike, përmirësimi i shërbimit dhe infrastrukturës, dhe çështjet me përparësi në bashkëpunimin ndërkombëtar. **[E1.5 fq. 3-7]** Pavarësisht se për grupin e vlerësimit ishte e qartë, nga diskutimet me stafin e lartë, akademik dhe administrativ, që strategjitë e zhvillimit diskutohen gjerësisht në çdo nivel të strukturës së komiteteve të Universitetit, nuk kishte asnjë procesverbal të këtyre mbledhjeve. Prandaj, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm thekson se procesverbalet e mbledhjeve, së bashku me vendimet përkatëse, veprimet dhe afatet kohore janë pjesë kyç e procesit të planifikimit dhe të veprimit. **[M1, M4, M5, M6, M8]** Plani Strategjik 2016-2020 parashikon se “Universiteti do të monitorohet dhe vlerësohet në bazë të treguesve të qëndrueshëm e të matshëm akademikë dhe institucionalë të performancës”. Për të siguruar që treguesit e performancës të përfshihen në planifikimin institucional, Universiteti duhet t’i kushtojë rëndësi zhvillimit, miratimit dhe zbatimit të një plani veprimi, në mbështetje të Planit të tij Strategjik 2016-2020. **[Kapitulli III Standardi I.5]**

- 1.10 Çdo vit, Rektorati i paraqet Senatit një raport, ku përfshihet analiza e treguesve të procesit të kërkimit dhe të të nxënit. **[Dokumente 1.15]** Raporti i paraqitet për shqyrtim Këshillave dhe Bordeve të Universitetit, dhe më pas i dorëzohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Raportet e Departamentit hartohen nga KSBC-ja. Mbi bazën e tyre, dekanët hartojnë raportet e fakultetit, dhe mbi bazën e këtyre të fundit Rektorati harton raportin që i dërgohet Ministrisë çdo vit. Nga bisedat me stafin u pohua se raportet e departamenteve dhe fakulteteve diskutohen gjerësisht në nivel Departamenti, Fakulteti dhe Rektorati, përpara se ato të përfshihen në raportin përfundimtar që i paraqitet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arrin në përfundim se procesi është i efektshëm. **[Kapitulli III Standardi I.6, Kapitulli III Standardi II.3] [ESG 1.8 Informacione Publike]**
- 1.11 Universiteti thekson se autonomia dhe liria e tij akademike mbështeten nga misioni dhe qëllimi i tij. Të drejtat e parashikuara me ligj përfshijnë hartimin e programeve të studimit dhe projekteve kërkimore; përzgjedhjen e stafit akademik dhe administrativ; kriteret e pranimit; dhe aftësinë për të nënshkruar marrëveshje me institucione brenda dhe jashtë vendit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm zhvilloi diskutime të hollësishme me drejtuesit e lartë, stafin akademik dhe administrativ dhe vuri re qartazi se Universiteti ka krijuar strukturat e duhura, për të përmbushur misionin dhe qëllimin e tij. **[M1, M2, M3, M4, M5, M6, M7, M8] Kapitulli III Standardi II.1]**
- 1.12 Universiteti synon të jetë një institucion lider, duke kontribuar në zhvillimin social e ekonomik të Shqipërisë, duke ofruar arsim të një cilësie të lartë në shërbim të shoqërisë, ekonomisë, politikës dhe zhvillimit të qëndrueshëm afatgjatë. Për ta arritur këtë, ai ka mekanizma për mbledhjen e informacionit dhe të dhënave për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, duke krijuar një Bord të Tregut të Punës që i bashkëngjitet çdo departamenti. **[M1, M4, M8, E3.1 Bordet e Tregut të Punës, E3.1 Procesverbali i Bordit të Tregut të Punës]** Bordet e Tregut të Punës kontribuojnë në departamentet e tyre përkatëse përmes vlerësimit të mësimdhënies dhe programeve mësimore, duke ndihmuar kështu, nga njëra anë, departamentet për të qenë në një linjë me kërkesat në ndryshim të tregjeve, dhe nga ana tjetër, studentët të marrin arsimim që nxit punësueshmërinë e tyre. Anëtarët e Bordeve të Tregut të Punës japin gjithashtu këshilla për karrierën dhe udhëzime për studentët. Disa

anëtarë të Bordeve të Tregut të Punës marrin pjesë në Asamblenë e Ortakëve, një organ këshillimor i Senatit Akademik. Anëtarët e Bordeve të Tregut të Punës vijnë nga fusha, si: industria, tregtia, profesionet e lira, media dhe qeverisja vendore. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e gjykon si **praktikë të mirë** krijimin e Bordeve të Tregut të Punës, për secilin departament, duke ndihmuar në garantimin e përshtatshmërisë së programeve dhe në nxitjen e punësueshmërisë së studentëve. [**Kapitulli III Standardi III.1, Kapitulli III Standardi III.2, Kapitulli III Standardi III.3**]

1.13 Çështja e ndërkombëtarizimit dhe lista e gjerë e organizatave partnere janë me përparësi për axhendën e universitetit, të cilat së bashku me kontributet e konsiderueshme të akademikëve evropianë dhe amerikanë, që marrin pjesë në konferencat dhe forumet e Universitetit, pasqyrojnë vizionin e tij strategjik. [**1.20, 1.14, 1.42, 1.54, 1.57, 3.2**] Në kuadër të marrëveshjeve të lartpërmendura, stafi dhe studentët nxiten të punojnë ose studiojnë në universitetet Perëndimore. Aktualisht, numrat janë modeste, por Plani Strategjik i Universitetit e thekson këtë si një fushë me përparësi zhvillimi për Universitetin. [**1.18, 1.19, 1.20, 1.22, 1.41, 1.65, 3.26**] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron si një **praktikë të mirë** larminë dhe cilësinë e bashkëpunimeve të Universitetit me universitete me reputacion jashtë Shqipërisë. [**Kapitulli III, Standardi III.2, Kapitulli III Standardi III.4**]

1.14 Përgjegjësitë për Organizimin dhe Menaxhimin e Universitetit përcaktohen qartë në Statutin dhe Rregulloret e Universitetit. [**1.1, 1.2**] Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pa si praktikë të mirë krijimin e Bordeve të Tregut të Punës për secilin departament, për të garantuar që programet të jenë të përshtatshme dhe për të nxitur punësueshmërinë e studentëve, si dhe sasinë dhe cilësinë e bashkëpunimeve që Universiteti ka me universitete me reputacion jashtë Shqipërisë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë dobësi. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi se Universiteti vazhdon të mbajë një qëndrim proaktiv, për të siguruar që institucioni të jetë gati karshi kuadrit të ri ligjor.

Gjetjet

Praktikë e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- krijimi i Bordeve të Tregut të Punës për secilin departament, për të garantuar përshtatshmërinë e programeve për studentët dhe për të nxitur punësueshmërinë e studentëve (pika 1.12)
- krijimi i bashkëpunimeve me universitete me reputacion jashtë Shqipërisë (pika 1.13).

Dobësi

Grupi i Vlerësimit të jashtëm nuk identifikoi ndonjë dobësi në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimi të jashtëm nuk bëri asnjë rekomandim në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet në proces si më poshtë:

- Universiteti mban një qëndrim proaktiv, për të siguruar që institucioni të jetë gati karshi kuadrit të ri ligjor.

Gjykimi

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

- 2.1 Universiteti kryen rekrutimin e stafit akademik dhe administrativ sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në Statut **[E1 Statuti, Nenet 8.2, 17.1]** dhe në Rregullore. **[Rregullorja E2, Nenet 6.2, 10.3]** Politikat, procedurat dhe kriteret për rekrutimin e stafit **[E21 Procedurat për rekrutimin e stafit]** janë publikuar në faqen e internetit të Universitetit dhe janë hartuar, për të treguar një qasje të hapur dhe të drejtë ndaj rekrutimit. Universiteti i jep përparësi kandidatëve me doktoratë të marrë nga një universitet Perëndimor, gjë që mbështet parimin e ndërkombëtarizimit. Dyzetekatër vetë, nga stafi akademik, kanë studiuar jashtë vendit për një kualifikim më të lartë **[E22 Lista e stafit që ka studiuar jashtë vendit]** dhe 26 kanë punuar jashtë vendit në arsimin e lartë, në pesë vitet e fundit. **[Anketimi i Stafit, Q3]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm çmon si **praktikë të mirë** mbështetjen që Universiteti ofron, duke ndihmuar stafin të studiojë për një kualifikim më të lartë në një institucion jashtë vendit. **[Kapitulli III Standardi IV.1; ESG 1.5 Stafi akademik]**
- 2.2 Ngarkesa e punës përcaktohet në një kontratë pune, e cila bazohet në Kodin e Punës dhe në Statut, dhe përcakton të drejtat dhe detyrat e të gjithë stafit akademik. Organigrama është e publikuar në faqen e internetit të Universitetit dhe sqaron strukturën e organizimit të Universitetit. **[Dokumente AE-10, Organigrama]** Pjesa më e madhe e stafit janë shtetas shqiptarë. Në 194 vetë të stafit akademik, 2 janë joshqiptarë. **[Dokumente AE-6, Përmbledhje e numrit të stafit]** **[Kapitulli III Standardi IV.1]** **[Kapitulli III Standardi IV.2]**
- 2.3 Universiteti mbështet trajnimin e profesorëve dhe studimet e tyre të doktoraturës brenda dhe jashtë vendit, nëpërmjet ofrimit të periudhave të paguara për studime kërkimore. Universiteti gjithashtu nxit angazhimin e profesorëve të huaj në mbikëqyrjen e tezave të doktoratës dhe pjesëmarrjen në konferenca të mbajtura në Universitet. **[E35, Axhenda e ASD]** **[Dokumente, AE-7, Trajnimi i Pedagogëve]** Universiteti ka synim tërheqjen e stafit akademik me doktoratë të fituar nga universitetet amerikane dhe evropiane. **[Mbledhja 1, Rektori]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron mbështetjen e ofruar nga Universiteti për trajnimin e pedagogëve dhe vazhdimin e studimeve të tyre të doktoratës, nëpërmjet ofrimit të periudhave të paguara për studime kërkimore, si karakteristikë pozitive. **[Kapitulli III Standardi IV.3]**
- 2.4 Vlerësimi i stafit akademik kryhet nga Përgjegjësi i Departamentit me anë të analizës së pyetësorëve të plotësuar nga studentët online dhe me anë të përdorimit të fokus grupeve, të organizuar në fund të vitit akademik. **[Dokumente 36, Statuti, Neni 17]** Secili nga Përgjegjësit e Departamentit ia raporton rezultatet Komisionit të Vlerësimit të Performancës, i cili nga ana e tij ia raporton Rektorit. **[E2, Rregulloret, Neni 23.2]** Stafi akademik pohoi se ata marrin trajnime në mbështetje të pozicioneve të tyre si mësimdhënës dhe se rishikimi i praktikës mësimore rezultoi konstruktiv. **[Mbledhja 4, Stafi i lartë drejtues]** Stafi pohoi se vëzhgimi i mësimdhënies nga kolegët bëhej një herë në dy vjet. Për stafin e sapoemëruar ka një periudhë prove. **[Mbledhja 5 me stafin akademik dhe kërkimor]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arrin në përfundim se qasja e Universitetit ndaj zhvillimit të stafit mund të përmirësohet, duke i bërë bashkë të gjitha elementet e veçanta të deritanishme. **[Kapitulli III Standardi IV.3]**

- 2.5 Në mbështetje të zhvillimit shoqëror, Universiteti organizon një sërë aktivitete sociale për të shkëmbyer ide dhe për të ndarë praktikën, duke përfshirë edhe darka festive, takime jashtë ambienteve të universitetit, dreka, festimi i ditëlindjeve, klubet e debatit dhe promovimi i librave. **[Dokumente 37 & 86, AE-16] [RVV, fq.11]** Organizohen takime të veçanta për të shqyrtuar zhvillimet e reja strategjike. **[Mbledhja i 1 Rektorit] [Mbledhja 5 me stafin akademik dhe kërkimor]** Janë kryer një varg aktivitete integruese dhe bashkëpunuese të efektshme, siç janë turet në shkollat e mesme, këshillimi i aplikantëve akademikë, ditë të hapura, takim me prindërit dhe javët e orientimit për studentët e saporegjistruar. Nga ana tjetër, turi i kthimit në universitet kryhet me drejtorët e shkollave të mesme, për të tërhequr maturantët e diplomuar nga shkollat e mesme në Universitet. **[Dokumente AE-11, Ditët e Hapura; AE-25, Ditët e Hapura; -AE-26, Turi në shkollat e mesme] [Kapitulli III Standardi IV.2] [Kapitulli III Standardi IV.4]**
- 2.6 Buxheti i Universitetit hartohet çdo muaj korrik dhe miratohet nga shoqëria Nisma për Arsimin Evropian Sh.p.k (European Education Initiative holding Ltd.). Përgjegjës për këtë janë Kancelari dhe Përgjegjësi i Financës. Buxheti përgatitet në mënyrë të kujdesshme, për të siguruar pagimin e të gjitha detyrimeve financiare. **[Dokumente 39 Statuti, neni 39 & AE-17, Pasqyrat financiare]** Kancelari (raporton te Rektori), me ndihmën e Përgjegjësit të Financës, përgatit projektbuxhetin vjetor në korrik, **[E1, Statuti, neni 22.1.1]** i cili kalohet për mendim në Senatën Akademik përpara se të marrë miratimin institucional. **[Statuti E1, Neni 19.1.6c; Neni 20, 21.3.1.3e] [Mbledhja 1, Rektori] [Kapitulli III Standardi VI.1] [Kapitulli III Standardi VI.3]**
- 2.7 Për 10 vitet e para, Universiteti për menaxhimin e buxhetit ka zbatuar një proces buxhetor të centralizuar, në vend të një qasjeje nga poshtë-lart. Sot, Dekanët dhe përgjegjësitë e departamenteve janë pjesë e procesit vjetor të menaxhimit të buxhetit. Gjithnjë e më shumë buxheti do të bazohet në një qasje nga poshtë-lart. **[Mbledhja 6 me stafin mbështetës]** Universiteti publikon një raport auditimi në lidhje me realizimin e buxhetit. Raportet e buxhetit sigurojnë transparencë në kontabilizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, dhe të gjitha llogaritë e kostove kontrollohen, për të garantuar qëndrueshmërinë. **[Dokumente 40 Statuti, pika 22.1.8]** Plani parashikon ecjen drejt një modeli të decentralizuar, ku funksionet kyçe i kalojnë departamenteve, deri në 2017. **[Mbledhja 8, Presidenti/Pronari]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e çmon si zhvillim synimin e Universitetit për ta kaluar buxhetin edhe në nivel të departamenteve, me qëllim nxitjen e autonomisë dhe sigurimin që buxheti vjetor të jetë objekt diskutimi në Senat, duke siguruar në këtë mënyrë transparencën në vendimmarrje. **[Kapitulli III Standardi VI.2]**
- 2.8 Sistemi i menaxhimit të informacionit të Universitetit është i efektshëm në koordinimin dhe mbështetjen e punës së stafit akademik dhe administrativ, si dhe në mbështetjen e procesit të të nxënies tek studentët. Sistemi ofron një numër elementesh mbështetëse, përfshirë laboratorët e TI-së, faqen e internet të Universitetit, sistemin e arkivave elektronike, sistemin e administrimit të studentëve dhe portalet e të nxënies për stafin akademik dhe studentët. Sistemet iu sigurojnë studentëve informacion për kalendarin e vitit akademik, orarin mësimor dhe rezultatet e provimeve. **[Dokumente AE-18, Platformat elektronike e UET-it]** Raporti i Vetëvlerësimit SWOT nxori dobësi të sistemeve të TI-së, megjithatë, blerja kohët e fundit e pajisjeve me fuqi të lartë dhe

softuerëve shtesë, si dhe ofrimi i 1 terabajt hapësirë ruajtje për çdo anëtar të stafit, i ka dhënë zgjidhje dobësive të identifikuar më parë. **[Mbledhja 6, stafi mbështetës] [Kapitulli III Standardi VII.1] [ESG 1.7 Menaxhimi i informacionit]**

- 2.9 Universiteti ka auditore me cilësi të mirë, të pajisura mirë, me pajisje audio-vizuale, kompjutera dhe projektorë. Katër laboratorët e TI-së janë të hapur si gjatë programit mësimor të planifikuar, ashtu edhe gjatë orëve të lira. Secili laborator ofron një gamë softuerësh dhe pajisjesh kompjuterike. Zyra e Teknologjisë së Informacionit dhe e TI-së merret me mirëmbajtjen dhe përditësimin e pajisjeve. Kampusi mbulohet nga Wi-Fi, megjithëse ka ende disa pika ku nuk kapin valët. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pa një demonstrim praktik të portaleve të pedagogëve dhe të studentëve, gjatë vizitës në kampus. Të dy portalet ishin gjithëpërfshirës në lidhje me gamën e aktiviteteve të ofruara. Zyra e Teknologjisë së Informacionit dhe e TI-së bën trajnime për stafin dhe studentët. Biblioteka ofron gjithashtu një numër të vogël kompjuterash, të aksesueshëm nga ora 9.00 deri në orën 20.00, gjatë ditëve të javës, dhe nga ora 9.00 deri në orën 17.00 të shtunave. **[Vlerësimi i burimeve të kampusit gjatë vizitës]** Studentët ishin të kënaqur me mjedisin e tyre të mësimit dhe pohuan se nëse ata ngrinin disa problematika, ato zgjidheshin shumë shpejt. Sistemet e TI-së konsideroheshin të efektshme. Si harduerët, ashtu dhe softuerët mbështesin të nxënit e studentëve. Edhe teknikët e TI-së i ndihmojnë studentët. **[Mbledhja 2, Studentët e ciklit të parë] [Mbledhja 3, studentët e ciklit të dytë dhe të tretë] [Kapitulli III Standardi VII.2] [ESG 1.6 Burimet e të nxënit dhe mbështetja e studentëve]**
- 2.10 Universiteti është i detyruar t'i përmbahet Statutit dhe t'i përdorë pronat e tij për qëllime arsimore ose qëllime të ngjashme. **[Statuti E1, Neni 8.6, 8.7]** Universiteti ka dy ndërtesa që zënë një sipërfaqe prej 12,340 m². Politika e menaxhimit të pronës parashikon rregullat dhe procedurat kryesore të zbatueshme për përdorimin e energjisë, mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e mbetjeve, politikat e pastrimit, sigurinë dhe parkimin e makinave. **[Dokumente AE-21, Politika e menaxhimit të pronës]** Universiteti po harton plane për një kampus të ri, për të nxitur shtimin e ardhshëm të numrit të studentëve dhe fushave të tjera të studimit. **[Mbledhja i 1 Rektori]** Aktualisht, Universiteti ka në pronësi një nga dy godinat që përdor. **[Mbledhja 8, Presidenti dhe Pronari] [Kapitulli III Standardi VII.3] [Kapitulli III Standardi VI]**
- 2.11 Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konsideron se të dyja godinat e Universitetit ofrojnë një mjedis të përshtatshëm për kryerjen e veprimtarisë së tij. Zyrat e personelit dhe ambienti janë në përputhje me kërkesat e shëndetit dhe sigurisë për kontrollin e temperaturës dhe sigurinë nga zjarri. Megjithatë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm thekson se studentët me aftësi të kufizuara nuk kanë akses te të gjithë ambientet e godinave të Universitetit, një çështje kjo e ngritur edhe në Raportin e Vetëvlerësimit. **[SWOT fq. 35]** Stafi akademik ishte i kënaqur me mjedisin e punës dhe qasjen në burimet e TI-së, **[Mbledhja 5, Anketimi i stafit akademik dhe kërkimor]** njësoj siç ishin edhe studentët. Megjithatë, studentët nxorën në pah mungesën e ashensorëve dhe shkallëve për dalje të urgjencës, **[Anketimi i Studentëve, pyetja 15.i]** rampave për personat me aftësi të kufizuara, **[Anketimi i Studentëve, pyetja 15. ii]** dhe mungesën e ambienteve sportive. **[Anketimi i Studentëve, pyetja 15.ix dhe 15.x]** Mosmarrja e masave për studentët me aftësi të kufizuara u pa si dobësi e Universitetit. Kjo mund të zgjidhet në kampusin e ri. Por, ndërkohë orët e mësimit po zhvillohen në klasat që

ofrojnë akses. **[Mbledhja 6, Stafi mbështetës]** Megjithëse standardet nuk cenohen, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konstatoi se, duke qenë se jo të gjitha ambientet e godinave të Universitetit janë të aksesueshme nga studentët me aftësi të kufizuara, do të ishte mirë që Universiteti të siguronte që infrastruktura aktuale të jetë e aksesueshme për të gjithë studentët e Universitetit, përfshirë personat me aftësi të kufizuara. **[Kapitulli III Standardi VII.4, 5 dhe 6] [Kapitulli III Standardi V.1]**

- 2.12 Për të mbështetur të nxënit e studentëve, biblioteka ofron një sërë materialesh, në format të shtypur dhe në format elektronik, për çdo program studimi. Listat e librave rishikohen çdo vit. Universiteti disponon mbi 5.000 tituj librash. Është i abonuar në SAGE për materiale online dhe ka akses në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë. **[Mbledhja 4, Stafi i lartë drejtues] [Mbledhja 5 me stafin akademik dhe kërkimor]** Studentët pohuan se materialet e bibliotekës ishin lehtësisht të aksesueshme. Orari i hapjes ishte i arsyeshëm, **[09- 20:00 nga e hëna deri të premten, 09- 17:00 të shtunave dhe një orë shtesë gjatë sezoneve të provimeve]** dhe se biblioteka ishte një mjedis i mirë pune, me kompjutera të lidhur me internet. **[Mbledhja 2, Studentët e ciklit të parë] [Mbledhja 3, studentët e ciklit të dytë dhe të tretë] [Kapitulli III Standardi V.1] [ESG 1.6 Burimet e të nxënit dhe mbështetja e studentëve]**
- 2.13 Ndërmarrja e UET-së ofron shërbime për palë të treta në formën e këshillimit. Shërbimet ofrohen në fushat e biznesit, burimeve njerëzore dhe TI-së. Cilësia e shërbimeve sigurohet me anë të vlerësimit të performancës kërkimore shkencore të stafit akademik, së bashku me numrin dhe llojin e kontratave të nënshkruara nga Universiteti. **[Dokumente AE-24, Këshillimi i palëve të treta] [Kapitulli III Standardi VII 5 dhe 6]**
- 2.14 Disa zyra të administratës janë përgjegjëse për mbajtjen e gjithë dokumentacionit të rëndësishëm të Universitetit. Një version elektronik i të gjitha dokumenteve ruhet dhe mirëmbahet nga Zyra e TI-së, me anë të sistemit UMIS. **[Dokumente 46, Rregullorja, neni 6]** Zyrat e Arkiv-Protokollit dhe Statistikave, Burimeve Njerëzore dhe Financave **[E2, Rregulloret Neni 6.2.9, 6.2.1, 6.2.8]** dhe zyra e kontratave **[RVV, fq.16]** janë përgjegjëse për mbajtjen e dokumentacionit të të gjitha aktiviteteve të Universitetit. Koordinator i departamentit menaxhon dokumentacionin e studentëve, si për shembull esetë, syllabuset e programeve dhe procesverbalet e mbledhjes. Sekretari Akademik menaxhon gjithashtu regjistrimet dhe provimet e lëndëve. Zyra e Arkivit-Protokollit dhe Statistikave mbledh të dhëna statistikore në lidhje me universitetin, të cilat më pas i bëhen me dije Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Të dhënat e ecurisë së studentëve ruhen në mënyrë elektronike në UMIS dhe në kopje fizike, duke marrë parasysh regjistrimin, bursistët dhe studentët, që kanë transferuar ose kanë ndërprerë studimet e tyre. **[Sistemi i Menaxhimit të të Nxënit, www.eut.edi.al/lme]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjykon se Universiteti ka bërë shumë punë, për të krijuar proceset e tij të menaxhimit të informacionit. Prandaj **thekson** që Universiteti duhet të vazhdojë të zhvillojë sistemet e tij të informacionit për të siguruar informacion strategjik e të integruar mbi punën e Universitetit. **[Kapitulli III Standardi V.2] [ESG 1.8 Menaxhimi i informacionit]**
- 2.15 Përgjegjësitë për burimet përcaktohen qartë në Statutin dhe Rregulloret e Universitetit. **[E1 & E2]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi si praktikë të mirë mbështetjen që i ofrohet stafit akademik, për të kryer një kualifikim më të lartë në një universitet jashtë

vendit. Infrastrukturën e godinës që nuk plotësonte tërësisht kërkesat e studentëve me aftësi të kufizuara u pa si dobësi. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që Universiteti të zhvillojë një strategji dhe një plan veprimi, për të siguruar që e gjithë infrastruktura aktuale të jetë e aksesueshme edhe nga studentët me aftësi të kufizuara. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi zhvillimet e vazhdueshme që mbështesin burimet e Universitetit, duke përfshirë zhvillimin e vazhdueshëm të sistemeve për menaxhimin e informacionit me qëllim sigurimin e informacionit strategjik dhe të integruar në lidhje me performancën e Universitetit.

Gjetjet

Praktikë e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- mbështetja që i ofrohet stafit akademik për të kryer një kualifikim më të lartë në një universitet jashtë vendit (pika 2.1).

Dobësi

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë dobësi në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimi të Jashtëm nuk bëri asnjë rekomandim në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet në proces si më poshtë:

- Universiteti të vazhdojë të zhvillojë sistemet e tij të menaxhimit të informacionit për të siguruar informacion strategjik dhe të integruar për performancën e Universitetit (pika 2.15).

Gjykimi

Standardet për Burimet janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

- 3.1 Në përputhje me Misionin e Universitetit, programet akademike mbështeten në kërkimet shkencore dhe në nevojat e punëdhënësve, të cilat bëhen të ditura nëpërmjet Bordeve të Tregut të Punës të Universitetit. **[Dokumente 1, Statuti. Neni 6]** Universiteti kërkon të pozicionohet si një “universitet i biznesit”, duke i kushtuar përparësi kurrikulës dhe programeve në disiplina që plotësojnë nevojat e tregut rajonal dhe kombëtar të punës. **[Dokumente 5, Plani Strategjik 2015-20, fq.7]** Bordet e Departamenteve të Tregut të Punës, të përbëra nga 10 partnerë të industrisë me një përqindje në rritje të të diplomuarve të Universitetit, shqyrtojnë çdo vit përshtatshmërinë e kurrikulës dhe elementet e praktikës profesionale, për të garantuar që risitë të përfshihen në syllabuset e vitit të ardhshëm. **[Dokumente 1, Statuti, Neni 18.2]** Shfrytëzimi i Bordeve të Tregut të Punës, të cilët shqyrtojnë çdo vit programin mësimor, duke siguruar përshtatshmërinë e tij dhe duke rritur punësueshmërinë e studentëve, është tipar i praktikës së mirë. **[Mbledhja 6]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjithashtu **pohoi** rolin në rritje të alumni në Bordet e Tregut të Punës, gjë që mban lidhjet me ish-studentët dhe zhvillon bashkëpunime të reja me industrinë, duke mbajtur në këtë mënyrë të angazhuar me Universitetin. **[Kapitulli I Standardi I.1]**
- 3.2 Të dhënat rreth programeve të studimit publikohen në faqen e internetit të Universitetit **[Dokumente, <http://www.uet.edu.al/index.php/sq/studio-ne-uet>]** si dhe në Prospektin e Universitetit, **[Dokumente, Guida e studimeve BA / MA / DR 2016-17]**, dhe të dyja janë edhe në gjuhën angleze. **[Dokumente shtesë 35b, Prospekt i Studentëve të UET-së]** Programet studimore janë të hapura për shtetas shqiptarë ose të huaj që plotësojnë kriteret e pranimit. **[Dokumente 2, Rregullorja, Neni 11]** Komisionet e fakultetit mbikëqyrin përzgjedhjen e kandidatëve të ciklit të parë. Kandidatët për programet Master zgjidhen nga Komiteti Shkencor përkatës, dhe studentët e doktoraturës zgjidhen nga Këshilli i Profesorëve. **[Dokumente 2, Rregullorja, Neni 12] [ESG 1.8 Informacione Publike]**
- 3.3 Të koordinuar nga Zyra e Pranimeve dhe Kujdesit ndaj Studentit, një ekip i përbërë nga stafi drejtues dhe ai akademik dhe studentë promovon programet çdo vit gjatë muajve mars-maj, duke zhvilluar një tur në shkollat e mesme. Në vitin 2016, u kryen 30 ture në 142 shkolla me rreth 15,346 aplikantë potencialë. **[Dokumente 31, Axhenda e tureve në shkollat e mesme; Dokumente shtesë 26, Fotografi dhe artikulli i MAPO-s për turin në shkollat e mesme]** Për më tepër, programet promovohen përmes takimeve individuale të aplikantëve me lektorë, vizita në universitet dhe fushata mediatike. **[RVV, fq.29; shtesë 26, Politika për promovimin e UET-së në internet; Dokumente shtesë 25, rendi i ditës dhe listat e pjesëmarrësve në ditët e hapura; Mbledhja 2, studentët e ciklit të parë; Mbledhja 3, Studentët pasuniversitarë]** Studentët e doktoraturës vunë në dukje se sekretaria i doktoraturës iu jep përgjigje pyetjeve rreth programit dhe se eventet e mbrojtjes së tezës së doktoratës janë të hapura për të gjithë, duke bërë të mundur që studentët e ardhshëm të shohin se çfarë bëhet. **[Mbledhja 3, Studentët pasuniversitarë]** Universiteti mban kontakte me shkollat e mesme, nëpërmjet forumit gjimnaz-universitet. **[RVV, fq.29]**
- 3.4 Gjatë regjistrimit, studentët e rinj këshillohen dhe orientohen nga një ekip profesorësh për zgjedhjet e tyre të studimit. **[RVV, fq.17]** Gjatë javës së parë dhe të dytë, fakulteti

sigurohet që studentët të kuptojnë objektivat e të nxëniet dhe të dinë si të kenë qasje në shërbimet e Universitetit dhe mundësitë e studimit, për shembull udhëtimi jashtë vendit. **[Dokumente 2, Rregullorja, Neni 37; Dokumente 32, Politika, kriteret dhe procesi i pranimit; Takimet 2, Studentët e padiplomuar, studentët pasuniversitarë]**

- 3.5 Duke qenë se aktualisht ofron vetëm programe me kohë të plotë, Universiteti nuk ofron një program studimi të edukimit të vazhdueshëm, pavarësisht se ofron trajnime, seminare dhe konferenca që mbështesin parimin e të mësuarit gjatë gjithë jetës, si p.sh. Ditët vjetore të studimeve shqiptare. **[RVV, fq.11; Dokumente 25, Axhenda e ASD-së]** Universiteti ofron një sërë programesh të zhvillimit të vazhdueshëm profesional për stafin akademik, përfshirë trajnimin për profesorët dhe mbikëqyrësit, si pjesë e strukturës dhe rregullores së shkollës së doktoraturës, **[Dokumente shtesë 7, Trajnime online për profesorët]** seminare shtesë për kërkuesit e rinj **[Dokumente 55, Prezantim i programeve të trajnimit]** **[Dokumente shtesë 28, Trajnime profesionale dhe seminare]** trajnime për mësimdhënien dhe kërkimin për stafin e ri **[Dokumente shtesë 12, përmbledhje e përmbajtjes së programit, ditët e trajnimit për zhvillimin e stafit dhe trajnim në menaxhim për stafin e lartë drejtues. [Dokumente shtesë 13, Planet e trajnimit për stafin drejtues dhe stafin akademik]** Për më tepër, stafi akademik me pesë vjet përvojë pune gëzon të drejtën e një viti sabatik të paguar. **[RVV, fq.34; Dokumente të vizitës 24, Numri i anëtarëve që kanë marrë lejen sabatike]** Pavarësisht se kjo përbën një ofertë të rëndësishme, nuk ishte e qartë nëse është strategjike dhe e koordinuar, dhe stafi akademik kishte informacion të kufizuara për të. **[Mbledhja 5, Stafi akademik]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjykon se Universiteti duhet të rrisë zhvillimin e stafit akademik në pedagogji dhe kërkim, duke zbatuar një qasje strategjike më të qartë dhe të integruar. **[Kapitulli I Standardi I.2]**
- 3.6 Kërkesat për vlerësimin, përparimin dhe diplomimin e studentëve përcaktohen qartë në Rregulloren përkatëse **[Dokumente 2, Rregullorja, Kapitujt 5 dhe 9]** dhe në nivelin e programit. **[p.sh. Dokumente 39, Rregullore e programit të studimit të ciklit të parë; Dokumente 47, rregullore e programit të studimit të ciklit të dytë]** Studentët pohuan se janë në dijeni dhe i kanë kuptuar qartë objektivat e të nxëniet dhe vlerësimit, mbi bazën e shpjegimeve të dhëna nga stafi dhe dokumentacioni i programit i dhënë në fillim të programit të studimit. **[Mbledhjet 2 dhe 3, Studentët e padiplomuar dhe pasuniversitarë]** **[Kapitulli I Standardi I.3]** **[ESG 1.4, Pranimi, përparimi, njohja dhe certifikimi i studentëve]**
- 3.7 Fokusi strategjik i Universitetit në përmbushjen e nevojave të punëdhënësve siguron koherencën e shërbimeve që ai ofron dhe harmonizimin me prirjet rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare. Mësimi në gjuhën angleze është në veçanti i efektshëm sepse pothuajse të gjithë studentët flisnin anglisht gjatë takimeve me Grupin e Vlerësimit. **[Mbledhjet 2 & 3, Studentët e padiplomuar dhe pasuniversitarë]** Grupi i Vlerësimit çmon si tipar të **praktikës së mirë** mësimin në gjuhën angleze në kurset e ciklit të parë, gjë që i aftëson studentët të komunikojnë në mënyrë të efektshme në gjuhën angleze dhe të kenë më shumë besim në mundësitë për mobilitet. Universiteti ndërmerr rregullisht nisma kërkimore të tregut, të cilat mbështesin gjithashtu zhvillimin e Shqipërisë, si për shembull “Raporti i Nismës së UET-së: Universiteti i Biznesit (2014-15)”, një kërkim kombëtar i kompetencave të të diplomuarve që kërkohen nga

punëdhënësit. **[RVV, fq. 18; Dokumente shtesë 33]** Universiteti aktualisht nuk ofron diploma të përbashkëta me institucione të tjera kombëtare ose ndërkombëtare, megjithëse kjo është një çështje me përparësi strategjike në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar. **[Dokumente 5, Plani Strategjik 2015-20, fq.6] [Kapitulli I Standardi I.4]**

- 3.8 Universiteti ka sisteme të cilat sigurojnë që ai të funksionojë brenda kapacitetit të burimeve fizike. **[RVV, fq.18; Dokumente 1, Përmbledhje e informacionit mbi kapacitetin e infrastrukturës institucionale]** Kriteret e menaxhimit të ngarkesës së stafit janë të përcaktuara qartë. **[Dokumente 37, Kriteret për shpërndarjen e ngarkesës së punës; Dokumente 23, model i kontratës së punës]** Kontrata e punëmarrësve parashikon pagesa për punë jashtë orarit, nëse orët e ngarkesës mësimore tejkalojnë numrin e rënë dakord. **[Dokumente 23, Shembull i Kontratës së Punës, Neni 16] [Kapitulli I Standardi I.5]**
- 3.9 Programet e studimit dhe objektivat e tyre janë të përcaktuara qartë dhe mund të gjenden edhe në faqen e internetit të Universitetit, gjë që iu ofron studentëve përmbajtjen e programeve, përfshirë syllabuset e detajuara të moduleve. Gjithashtu, kriteret e pranimit dhe procedurat e aplikimit janë të publikuara në faqen zyrtare të internetit. **[Dokumente shtesë 31]** Studentët konfirmuan se kriteret e pranimit, përmbajtja e programit dhe objektivat e të nxënies ishin të qarta. **[Takimet 2 & 3, Studentët e padiplomuar dhe pasuniversitarë] [Kapitulli I, Standardi I.6] [hartimi dhe miratimi i programeve]** Programet e studimeve të ciklit të parë i pajisin studentët me njohuri dhe koncepte themelore, edukim qytetar dhe metodat e parimet shkencore, duke siguruar që ata të zhvillojnë aftësitë e nevojshme analitike dhe kërkimore dhe të përgatiten për studimet e nivelit Master. **[RVV, fq.19; Dokumente 45, Për parimet e projektimit të programit të kursit dhe literatura, A.III.4.1.1]** Universiteti mbështet në parimin që studentët mund të kryejnë transferimin e krediteve nga dhe tek institucione të tjera në përputhje me Procesin e Bolonjës, **[Dokumente 41, Për transferimin dhe mobilitetin e studentëve, Mbledhjet 2 dhe 3, Studentët e padiplomuar dhe pasuniversitarë]** duke nxitur kështu mobilitetin, gjë që lehtësohet edhe përmes bashkëpunimeve institucionale. **[Dokumente 42, Lista e Universiteteve Partnere dhe Marrëveshjeve të Bashkëpunimit]** Rëndësia që i kushtohet praktikës dhe stazhit profesional, iu jep studentëve të ciklit të parë mundësi që ata të zbatojnë në praktikë njohuritë teorike, si edhe i përgatit ata për punësim. **[Kapitulli I Standardi I.6 & Kapitulli I Standardi I.7] [ESG 1.2 Hartimi dhe miratimi i programeve]**
- 3.10 Metodat e mësimdhënies të ciklit të parë ndryshojnë në varësi të llojit të kurseve që studiohen brenda një programi. Kurset teorike zakonisht zhvillohen përmes leksioneve dhe kolegumeve, ndërsa kurset profesionale janë ndërvepruese, duke kombinuar leksionet dhe seminare. Kurset praktike zhvillohen përmes seminareve ose aktiviteteve laboratorike. **[Dokumente 2, Rregullorja, Neni 16; Dokumente 45, A.III.4.1.2, Metodatat pedagogjike]** Shtatëdhjetë për qind e mësimdhënies kryhet nga staf akademik me kohë të plotë. **[RVV, fq.20; Dokumente 8, Statistikat e stafit akademik dhe shkencor 2015-16]** Orientimi dhe procesi i mentorimit të studentëve fillon përpara regjistrimit dhe vazhdon edhe pas diplomimit. Shërbimet mbështetëse ofrohen nga disa struktura, të tillë janë: Zyra e Pranimeve dhe Kujdesit ndaj Studentit; Zyra e Karrierës dhe Praktikës; Qendra e Këshillimit Akademik; ditët e këshillimit akademik dhe

orientimit. **[Dokumente 130/131/132, Urdhri i Rektorit/Rregullorja, Neni 38/Seanca metodologjike]** Studentët përshtaten me jetën e Universitetit gjatë ciklit të parë dhe të gjithë studentët kanë mundësi të ndryshojnë studimet e tyre në përputhje me rregulloret e Universitetit. **[Dokumente 133, Statuti, neni 26]** Studentët konsideronin se informacioni i dhënë gjatë fazës së orientimit ishte detajuar dhe i kuptueshëm. Sekretaria e fakultetit jep informacion për secili program të fakultetit, e më pas Dekani i Fakultetit jep shpjegime në lidhje me programin e studimit. **[Mbledhja 2, Studentët e ciklit të parë]** **[Mbledhja 3, Studentët e ciklit të dytë dhe të tretë]** Zyra e Karrierës dhe Praktikës jep këshilla për karrierën, organizon praktika profesionale dhe Panairët vjetore të punës, dhe mban lidhjet me të diplomuarit **[RVV, fq. 31]** Njësia e shërbimit të aftësisë së kufizuara ofron mbështetje për personat me aftësi të kufizuara, **[RVV, fq. 32]** si për shembull, duke mbështetur një student të verbër **[Mbledhja 2, Studentët]**, ndërsa Klinika Psikologjike ofron mbështetje emocionale. **[Dokumente 66, Urdhri i Rektorit Nr.12; Mbledhja 6, Stafi mbështetës]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjykon se qasja e diferencuar dhe gjithëpërfshirëse për mbështetjen e studentëve, duke përfshirë kërkesat fillestare të programit, tutorialet, zhvillimin e karrierës, kujdesin ndaj aftësisë së kufizuar dhe mbështetja emocionale janë tipare të **praktikës së mirë. [Kapitulli I Standardi I.8]**

- 3.11 Studimet e ciklit të dytë nxisin zgjerimin e njohurive dhe kërkimin e pavarur. **[Dokumente 46, Udhëzues për Shkrimin e Tezës së Diplomës]** Programet pasuniversitare dhe temat e kërkimit për studentët zakonisht janë brenda interesave kërkimore të stafit, duke lehtësuar kështu zhvillimin e grupeve kërkimore të studentëve. Të paktën 70 për qind e stafit akademik të ciklit të dytë janë punonjës me kohë të plotë. **[Dokumente 8, Statistikat e stafit akademik dhe shkencor 2015-16]** Pavarësisht se stafi akademik zakonisht pretendohet të ketë një doktoratë dhe përvojë mësimdhënie në universitet, kishte mësimdhënës që jepnin mësim, të cilëve ju mungonte përgatitja e nivelit të lartë akademik për të kontribuar në mësimdhënie. **[Dokumente 21, Rekrutimi i stafit akademik, G.1.3]** Krahas kërkimit të pavarur, për studimet e ciklit të dytë, praktika profesionale është element i detyrueshëm. **[Dokumente 49, Për Praktikën Profesionale; Dokumente 47, Rregullore e programit të ciklit të dytë të studimit: Komunikimi-marrëdhëniet me publikun]** Programet e ciklit të tretë, të hartuara në vitin 2011 dhe të publikuara në shqip dhe anglisht, **[RVV, fq.4 dhe fq.32]** përfshijnë tre programe doktorate në shkencat juridike, sociale dhe ekonomike, pra një për çdo fakultet. Secili program mbështetet në kërkimin e pavarur dhe krijues; ka një kohëzgjatje prej të paktën tre vitesh; viti i parë përfshin një modul studimesh teorike me 60 kredite dhe kulmon me paraqitjen dhe mbrojtjen e tezës së diplomës. **[Dokumente 2, Rregullorja, 3.9, 39.3, dhe aneksi; Dokumente 46: Udhëzues për shkrimin e tezës së diplomës; Mbledhje 3, Studentët pasuniversitarë]** Ashtu sikurse në rastin e studimeve të ciklit të parë, kurrikula (përfshirë praktikën profesionale) përditësohet me anë të rishikimeve vjetore, duke marrë për bazë informacionin e mbledhur nga bordet e tregut të punës dhe nga kërkimi i tregut. Për më tepër, studentët pasuniversitarë marrin pjesë në Panairin vjetor të punës. Si rezultat, pothuajse 25 për qind gjejnë vend pune. **[Mbledhja 3, Studentët pasuniversitarë] [Kapitulli I Standardi I.9]**
- 3.12 Strategjia e ndërkombëtarizimit dhe mobilitetit të studentëve janë strategji kyçe për Universitetin. **[Dokumente 5, Plani Strategjik 2015-20]** Për realizimin e këtyre

strategjive, programet e studimit janë në përputhje me Procesin e Bolonjës e kuptohen lehtësisht edhe nga ata që janë jashtë Shqipërisë. Rregullorja e Universitetit për transferimin, njohjen e krediteve dhe mobilitetin e studentëve **[Dokumente 41]** siguron një kuadër të qartë për lehtësimin e transferimeve të studentëve prej dhe nga Universiteti. Diplomat e dhëna në përfundim të studimeve përfshijnë një listë notash të detajuar. **[Kapitulli I Standardi I.10]**

- 3.13 Të gjitha programet, pavarësisht nga numri lëndëve teorike, parashikojnë që të gjithë studentët të kryejnë praktikën profesionale. **[Dokumente 45, mbi parimet e hartimit të programit të kursit dhe literatura, A.III.3 (i)]** Studentët e ciklit të parë dhe të dytë përgatisin një tezë dhe i nënshtrohen një mbrojtje publike formale të tezës. Në rastin e studentëve të ciklit të dytë, kriteri kryesor i vlerësimit është origjinaliteti. **[Dokumente 46, Udhëzues për shkrimin e tezës së diplomës, fq.10]** Në disa raste, studentët kanë mundësi të kontribuojnë në kërkime shkencore. **[Dokumente 50, Sistemi i Vlerësimit të Studentit, AV3, Mbledhja 5, Stafi akademik]** Në përputhje me aspiratat e tij për të zhvilluar studentë të vetëdijshëm ndaj detyrimeve civile, Universiteti dhe Zyra e Studentëve nxisin pjesëmarrjen në aktivitete ekstrakurrikulare, kulturore dhe shoqërore që mbulojnë një gamë të gjerë temash, si për shembull letërsia, debati, politika, ekonomia, sociologjia, sporti dhe udhëtimi. **[RVV, fq.34; <http://uet.edu.al/index.php/en/student-life/student-activities-and-clubs>]** Këto aktivitete iu japin studentëve mundësi për të zhvilluar aftësitë profesionale. **[Takimet 2 & 3, Studentët e padiplomuar, studentët pasuniversitarë] [Kapitulli I Standardi I.11]**
- 3.14 Universiteti i kushton rëndësi të veçantë zhvillimit të qytetarëve aktivë **[RVV, fq. 21]** dhe të diplomuarve të gatshëm për t'u punësuar, që gjë lehtësohet nëpërmjet praktikave dhe stazheve, **[Dokumente 49, Për praktikën profesionale]** për shembull caktimi për zhvillimin e stazhit në një firmë ligjore, **[Mbledhja 2, Studentët]** përvoja e gazetarëve-reporterëve, **[Mbledhja 3, Studentët pasuniversitarë]** vizita në biznese dhe institucione, **[RVV, fq.21]** fjalime për industrinë të mbajtura nga praktikantët, mbikëqyrës së industrisë, **[RVV, fq.20; Dokumente 21, Rekrutimi i stafit akademik, G.1.3]** dhe Panairi vjetor i punës, ku marrin pjesë punëdhënës të mëdhenj. **[Dokumente 48, Lista e shoqërive pjesëmarrëse në Panairin e Karrierës] [Kapitulli I Standardi I.12]**
- 3.15 Universitetit përqendrohet në një kurrikul mësimore e cila mbështetet në përparësitë rajonale dhe kombëtare të tregut të punës. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjykoj si **praktikë të mirë** krijimin e Bordeve të Tregut të Punës, mësimin e gjuhës angleze për studentët e ciklit të parë dhe qasjen e diferencuar dhe gjithëpërfshirëse në mbështetje të studentëve, duke përfshirë kërkesat fillestare të programit, tutorialet, zhvillimin e karrierës, kujdesin për personat me aftësi të kufizuara dhe mbështetje emocionale. Grupi nuk identifikoi asnjë **dobësi** dhe nuk dha ndonjë **rekomandim**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **pohon** rritjen e rolit të alumni në Bordet e Tregut të Punës dhe në aktivitetet institucionale.

Gjetjet

Praktika e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Bordet e Tregut të Punës të çdo departamenti, të cilët rishqyrtojnë programin e kurrikulës çdo vit, për të siguruar përshtatshmërinë e saj dhe për të nxitur punësueshmërinë e studentëve (pika 3.1)
- zhvillimi i strukturuar i mësimit në gjuhën angleze në kurset e ciklit të parë aftëson studentët të komunikojnë shumë mirë në gjuhën angleze dhe të kenë më shumë besim në mundësitë e mobilitetit (pika 3.7)
- qasja e diferencuar dhe gjithëpërfshirëse në mbështetje të studentëve, duke përfshirë kërkesat fillestare të programit, tutorialet, zhvillimin e karrierës, kujdesin për personat me aftësi të kufizuara dhe mbështetjen emocionale (pika 3.10)

Dobësi

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë dobësi në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk bëri asnjë rekomandim në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet në proces si më poshtë:

- rritja e rolit të alumni në Bordet e Tregut të Punës dhe në aktivitetet institucionale, mban lidhjet me ish-studentët dhe zhvillon bashkëpunime të reja me industrinë, duke ruajtur kështu angazhimin e tyre me Universitetin (pika 3.1).

Gjykimi

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënie, Vlerësimi dhe Kërkimi

- 4.1 Universiteti organizon programet e tij të studimit duke ruajtur ekuilibrin midis lëndëve përgjatë semestrave dhe viteve akademike dhe mundëson përmbushjen e ngarkesës mësimore të stafit akademik. **[Dokumente 51]** Faqja e internet e Universitetit përmban informacion të detajuar për çdo program studimi. **[Dokumente 45; RVV 79]** Në bazë të Ligjit për arsimin e lartë, praktika profesionale është një element i detyrueshëm për studentët e ciklit të parë dhe të dytë. Praktikrat zhvillohen pranë shoqërive të ndryshme, nën mbikëqyrjen e përbashkët të departamentit dhe organizatës pritëse. **[Dokumente 49, M2, M3, M5]** Universiteti ka krijuar një Bord të Tregut të Punës për çdo departament, i cili këshillohet me departamentet, për të siguruar cilësinë e praktikës profesionale për çdo program studimi. **[Dokumente 2; M4; M6; M8]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e gjykon si **praktikë të mirë** mbështetjen që iu ofrohet studentëve gjatë periudhës së praktikës profesionale, në kuadër të programeve të tyre të studimit. **[Mbledhja 2 dhe 3] [Kapitulli I, Standardi II.1]**
- 4.2 Vlerësimi i studentëve bazohet në parimin e vlerësimit të vazhdueshëm. Rregulloret përcaktojnë formatin dhe strukturën e tezës dhe procedurat e provimit. **[Dokumente 2; 50; M2, M3]** Vlerësimet konsiderohen të drejta dhe objektive. Universiteti respekton parimin e konfidencialitetit në provime dhe studentët informohen për rezultatet e provimit, duke përdorur sistemin elektronik UMIS. Për të siguruar përputhshmërinë me procedurat e provimit, provimet kontrollohen gjithmonë nga Përgjegjësi i Departamentit, titullari i lëndës dhe Përgjegjësi i Njesisë për Sigurimin e Cilësisë. **[Dokumente 50; M5]** Universiteti ka hartuar një rregullore të hollësishme për përgatitjen e tezave të diplomës/disertacionit, duke përfshirë rregulla për çdo departament dhe mbrojtjen e tezave para Komisionit Vlerësues. **[Dokumente 2; 46; Mbledhja 3]** Për sa i takon origjinalitetit të tyre, Universiteti ka miratuar Deklaratën e origjinalitetit, dhe të gjitha punimet i nënshtrohen kontrolleve të plagjiaturës. **[Dokumente plotësuese 29; M3]** Universiteti është abonuar në softuerin e zbulimit të plagjiaturës, ku të gjitha tezat e Masterit dhe doktoratës ngarkohen në këtë sistem. **[Dokumente 46, Udhëzues për përgatitjen e tezës së diplomës; M5 Stafi akademik dhe kërkimor]** Në kuadër të këtyre ndryshimeve procedurale të kohëve të fundit, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e nxit Universitetin që të zhvillojë dhe përmirësojë më tej sistemin (Tumitin) për të mbështetur më fuqishëm zbulimin e plagjiaturës, si për shembull me anë të seminareve dhe trajnimeve për studentët. **[Kapitulli I Standardi II.2] [ESG 1.3, Të nxënit me në qendër studentin, mësimdhënia dhe vlerësimi; 1.4 Pranimi, përparimi, njohja dhe certifikimi i studentëve]**
- 4.3 Programet e studimit përmirësohen nëpërmjet një sërë procesesh të ndërthurura, të cilat përfshijnë vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies nga Përgjegjësi i Departamentit, anketimin e studentëve një herë në semestër, shqyrtimin nga Komisioni vlerësues i performancës dhe Njësinë e Sigurimit të Cilësisë. **[Dokumente 21, 63, Mbledhja 4 dhe 5]** Cilësia e mësimdhënies është përmirësuar duke trajnuar stafin akademik dhe kërkimor, duke përfshirë si ekspertë të brendshëm, ashtu edhe të jashtëm. **[Dokumente 55]** Universiteti nxit lektorët të marrin pjesë në veprimtari kërkimore si brenda, ashtu edhe jashtë vendit, me qëllim përmirësimin e kërkimit shkencor.

[Dokumente 33] Në fund të vitit akademik, institucioni përgatit një raport vlerësimi të mësimdhënies, që hartohet nga Përgjegjësi i Departamentit, dhe përmban edhe një raport të shkurtër statistikor rreth performancës së mësimdhënies. **[Dokumente 38, Mbledhja 4, Mbledhja 5]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjykon se raporti vjetor i mësimdhënies, i përgatitur nga Përgjegjësi i Departamentit, ishte i efektshëm. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i mendimit se Universiteti duhet të vazhdojë të zbatojë rezultatet kyç të analizës së procesit mësimor, për të përmirësuar dhe mbështetur mësimdhënien me cilësi të mirë. **[Kapitulli I Standardi II.3] [ESG 1.9 Monitorimi i vazhdueshëm dhe rishikimi periodik i programeve]**

- 4.4 Strategjia e Universitetit i jep përparësi punësimit të stafit të kualifikuar, investimeve në burimet kërkimore, si për shembull, në biblioteka, angazhimit në projekte ndërkombëtare, mbështetjes së studentëve me anë të bursave, duke përfshirë edhe studentët e marginalizuar, **[RVV, fq. 24; Dokumente 5, Plani Strategjik 2015-2020]** dhe rekrutimit të stafit kërkimor aktiv dhe shumë të kualifikuar. Në kuadër të kësaj të fundit, vlerësimi i performancës kërkimore të stafit bëhet përmes një programi me katër faza vlerësimi, i cili vlerëson performancën kërkimore individuale duke u përqendruar në: përditësimin e kërkimit studimor, përcaktimin e përvojës kërkimore individuale, si për shembull, mbikëqyrja e tezave të brendshme; realizimin e financimit nga palë të treta dhe njohjen e jashtme si ekspert. **[Dokumente 33, Sistemi i fondeve të kërkimit dhe treguesit e matjes së performancës kërkimore shkencore]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e nxit Universitetin të përmirësojë më tej procesin e vlerësimit me katër faza për stafin kërkimor, duke siguruar një kuadër për stafin që dëshiron të zhvillojë një profil kërkimor. **[Kapitulli I Standardi II.4]**
- 4.5 Universiteti nxit stafin akademik të marrë pjesë në projekte kërkimore shkencore për të cilat ofrohen fonde, si nga Universiteti, ashtu edhe nga organizata të treta. **[Dokumente 33; 35; 58]** Zyra e zhvillimit të projekteve dhe bashkëpunimeve mbështet dhe koordinon aktivitetet që lidhen me projekte kërkimore shkencore të stafit. **[Dokumente 59, Mbledhja 5]** Aktivitetet kërkimore maten mbi bazën e rezultateve shkencore dhe të drejtimit të kërkimit me të cilin stafi është i angazhuar. Raportimi bëhet periodikisht në departament dhe vlerësohet nga Këshilli i Profesorëve. **[Dokumente 60; AE25, Mbledhja 4] [Kapitulli II, Standardi I.1]**
- 4.6 Universiteti është përfshirë në projekte që synojnë ngritjen e kapaciteteve me partnerë vendas dhe ndërkombëtarë në një sërë fushash, përfshirë konferencat pritëse, si për shembull Ditët e studimeve shqiptare. **[Dokumente 60, 61, 25, Mbledhja 4,5]** Universiteti bashkëpunon me universitete evropiane në projekte të programit Erasmus+ në të gjitha fushat e studimit që ofron Universiteti. Universiteti ka 90 marrëveshje bashkëpunimi me institucione ndërkombëtare dhe 13 marrëveshje me institucione kombëtare. **[RVV 102; AE2]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e nxit Universitetin të vazhdojë të mbështesë stafin në aplikime për projekte kërkimore ndërkombëtare, për të rritur më tej reputacionin ndërkombëtar të Universitetit. Stafi akademik nxitet të bëjë botime në rang ndërkombëtar dhe të marrë pjesë si referues në panele të punimeve të konferencave. **[Dokumente 23; 38, Mbledhja 4]** Nga pjesëmarrja aktive në bashkëpunime, Universiteti ka përfitime të mëdha. Deri më sot, Universiteti është angazhuar në shtatë projekte të BE-së për ngritjen e kapaciteteve, një sërë projektesh kërkimore rajonale, 300 raste mobiliteti me jashtë, pesë

shkëmbime hyrëse dhe një numër shkollash verore. Gjithashtu ka pasur edhe një numër lektorësh të ftuar. **[Dokumente 15, 18, Mbledhja 5]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm çmon se angazhimi aktiv në marrëveshjet dhe bashkëpunimet kombëtare dhe ndërkombëtare është një **praktikë e mirë**. **[Kapitulli II, Standardi I.2; Kapitulli II, Standardi I.3]**

- 4.7 Misioni dhe vizioni i Universitetit pasqyrohen në strategjinë e kërkimit shkencor, e cila miratohet nga Këshilli i Profesorëve dhe drejtohet nga drejtues të fushave të veçanta. **[Dokumente 60, M8]** Projektet kërkimore synojnë të rrisin aktivitetin ndërdisiplinor, të mbështesin aplikimet për fonde, të ofrojnë mundësi të krijimit të rrjeteve me sektorët privatë dhe të kulmojnë në publikimin e rezultateve dhe gjetjeve, duke ndarë njohuritë me të tjerët. **[Dokumente 37; Mbledhja 5]** Çdo anëtar i stafit akademik të departamenteve përkatëse cakton drejtimet individuale në fushën e ekspertizës kërkimore. Stafi angazhohet në drejtime të rëndësishme kërkimore, që konceptohen si grupe pune të stafit akademik me përvojë në fushat që kanë lidhje me aktivitetin. **[Dokumente 57; AE23; Mbledhja 4; M5]**, Është publikuar një raport statistikor mbi rezultatet e kërkimit shkencor individual të stafit. Nga mesi i tetorit të vitit 2016, do të publikohet raporti për projektet kërkimore të vitit akademik 2015-2016. **[Dokumente 40; Dokumente shtesë 3a; Mbledhja 5]** Departamentet e Universitetit punojnë me Shkollën e Doktoratës dhe Zyrën e projekteve të bashkëpunimit, të cilat mbështesin stafin akademik dhe vlerësojnë punën e secilit prej tyre. Bordi për financimin e veprimtarive kërkimore është përgjegjës për përzgjedhjen e projekteve kërkimore që financohen nga UET-ja. **[E 58]** Çdo vit, Universiteti mbështet një sërë projektsh kërkimore individuale me ndikim të drejtpërdrejtë në shoqëri. **[Dokumente 62, Lista e dokumenteve politike të botuara nga stafi]** **[Kapitulli II Standardi I.4 dhe Kapitulli II, Standardi I.5]**
- 4.8 Universiteti ka një strategji pesë vjeçare të kërkimit shkencor, e cila synon të mbështesë ndërkombëtarizimin, zhvillimin e projekteve dhe kërkimin shkencor. Universiteti ka venë në dispozicion një buxhet prej 500,000 euro **[RVV fq. 27; E60 Politika e Kërkimit Shkencor; E9 Shqipëria inovative 2020; AE23 Plani i veprimit për vlerësimin e strategjisë së kërkimit; Mbledhja 5]** Ky fond është shpërndarë në këtë mënyrë: 85 për qind për kërkime shkencore për stafin e brendshëm, 10 për qind për stafin akademik të ftuar dhe 5 për qind për projektet kërkimore të studentëve. Stafi përfiton zhvillim profesional, nëpërmjet programeve të shkëmbimit duke rritur njohuritë, përmirëson gjuhën angleze, përmirëson aftësitë e krijimit të kontakteve, fiton përvojë më të mirë mësimore dhe zhvillon metoda të reja. Janë krijuar mundësi për zgjerimin e rrjetit të partnerëve dhe për aplikimin në projekte të tjera. **[Dokumente plotësuese 33; Mbledhja 5 me stafin akademik dhe kërkimor, dhe përgjigjet nga pyetjet sqaruese]** Universiteti paraqiti një sërë shembujsh të planeve të veprimit për programet e tij kërkimore. **[Dokumente plotësuese 47; Mbledhja 4]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e nxit Universitetin të përgatisë një plan veprimi të qartë, i cili do të shërbejë për përmirësimin e zbatimit të programeve kërkimore (Shqipëria inovative 2015-2022). Planet e veprimit do të kenë objektiva të qarta, tregues kyç të performancës dhe afate të caktuara për realizimin e veprimeve, që do të kryhen nga personat përkatës. **[Kapitulli II, Standardi I.6]**

- 4.9 Rezultatet e kërkimit shkencor publikohen gjatë konferencave shkencore të organizuara nga Universiteti, si për shembull në Rrjetin e Evropës së Ardhshme. **[RVV 112]** Shtypi i Universitetit bën botime periodike. Të gjithë artikujt vlerësohen nga ekspertë me anë të një procesi shqyrtimi nga kolegët. **[RVV 113; E27; Përgjigja 4 nga pyetjet sqaruese]** Stafi akademik nxitet të publikojë kërkime shkencore në media për të ofruar ekspertizë për çështje me interes publik. Puna e shtypit të vet Universitetit është me rëndësi të veçantë. Aty bëhen botime periodike të vlerësuara nga grupet e kolegëve, duke përfshirë teza dhe monografi, ese dhe studime, dhe, dy herë në vit, revista në lidhje me secilin prej fakulteteve (*Economicus, Jus & Justicia, Polis, Analiza Arsimore* dhe *Sociologjike*) **[RVV, fq.28; Përgjigjet e pyetjeve sqaruese]** Gjithashtu botohen libra, përfshirë përkthime të teksteve shkollore. **[RVV, fq.28]** Autorët janë të brendshëm dhe të jashtëm. **[Dokumente plotësuese 29]** Krijimi i shtypit të vet Universitetit, ku publikohen si tekste shkollore, ashtu edhe kërkime, duke rritur kështu përvojën e studentëve dhe të stafit mbështetës në shpërndarjen e rezultateve të kërkimit, është një tipar i **praktikës së mirë**. **[E34, Broshura e botimeve të UET-së Press, E69, Inventar i bibliotekës së botimeve periodike, AE 26, Foto nga artikujt të MAPO-s, vizita në bibliotekë ku u panë shumë revista periodike të UET-së në raftet e librave [Kapitulli II, Standardi I.7]**
- 4.10 Universiteti monitoron dhe vlerëson në mënyrë periodike rezultatet e punës shkencore të stafit akademik, raportet e performancës së aktiviteteve kërkimore shkencore, rezultatet e projekteve kërkimore individuale dhe rezultatet konkrete si botimet kombëtare, ashtu edhe ato ndërkombëtare me faktorët e ndikimit, përfshirë pjesëmarrjen në konferenca. **[Dokumente 63; 52; Dokumente shtesë 3b; Mbledhja 5]** Universiteti është i zotuar të transferojë rezultatet e kërkimit tek gjithë shoqëria. Dy shembuj të tillë janë Projekti ConSus, i cili synon të krijojë një rrjet shkencor rajonal për inovacionin e qëndrueshëm, dhe Forumi biznesit, i cili synon të bashkëpunojë me bizneset më të suksesshme në vend. **[RVV 117 <http://ëëë.uet.edu.al/index.php/sq/consus-tempus>]** **Kapitulli II, Standardi I.8]**
- 4.11 Përgjegjësitë për menaxhimin e Mësimdhënies, Mësimnxënies, Vlerësimit dhe Kërkimit janë përcaktuar qartë në Strategjinë e Kërkimit dhe Politikat e Kërkimit Shkencor të universitetit. **[Dokumente 6, Strategjia e Kërkimit 2011-2015; 60 Broshura e dokumenteve për politikat e kërkimit shkencor]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm njohu dy aspekte të praktikës së mirë: angazhimin aktiv në marrëveshjet e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar dhe partneritetet; dhe krijimin e shtëpisë botuese të vet Universitetit, e cila publikon tekstet dhe kërkimet. Grupi i Vlerësimi të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë dobësi, nuk bërë rekomandime apo pohime.

Gjetjet

Praktikë e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- angazhimi aktiv në marrëveshjet e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar dhe partneritetet (pika 4.6)

- krijimi e shtypit të vet Universitetit, i cili publikon si tekstet mësimore, ashtu edhe kërkimet, duke përmirësuar kështu përvojën e studentëve dhe të stafit mbështetës në shpërndarjen e rezultateve të kërkimit (pika 4.9).

Dobësi

Grupi i Vlerësimi të Jashtëm nuk identifikoi ndonjë dobësi në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimi të Jashtëm nuk bëri asnjë rekomandim në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimi të Jashtëm nuk pohoi ndonjë veprim në proces në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

Gjykim

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

- 5.1 Sistemi aktual i pranimit të studentëve bazohet në legjislacionin shtetëror dhe rregulloret e brendshme. **[Dokumente 118, Kriteret e procesit të pranimit]** Kriteret e pranimit janë publikuar në internet; janë në dispozicion në median e shkruar dhe ofrohen gjatë vizitave në shkollat e mesme. **[Dokumente 119, Faqja e internetit study-in-eut]. [Dokumente 120, Rregullorja, neni 6]** Universiteti kryen një sërë aktivitetesh që lidhen me procesin e pranimit, përfshirë forumet gjimnaz-universitet, turet në shkollat e mesme, këshillimi i aplikantëve, fushatat mediatike, ditët e orientimit të karrierës dhe ditët e hapura. **[Dokumente 121/122/123/124/125/126]** Përpara se të pranohen në Universitet, studentëve në gjimnaze iu ishin dhënë broshura, ata kishin bërë vizita në Universitet për të takuar stafin dhe studentë dhe kishin marrë prezantime të printuara. Gjithashtu, ditët e hapura janë në dispozicion që prindërit të marrin informacion rreth Universitetit dhe ofertës së tij akademike. **[Mbledhja 2, Studentët e ciklit të parë]. [Mbledhja 3, studentët e ciklit të dytë dhe të tretë]** Studentët pohuan se ishin të kënaqur me shërbimet e marra nga zyra e pranimeve. **[Mbledhja 2, Studentët e ciklit të parë] [Mbledhja 3, Studentët e ciklit të dytë dhe të tretë] [Kapitulli I Standardi III.1]**
- 5.2 Universiteti mirëpret studentët joshqiptarë në programet e tij të studimit. Megjithatë, numri i studentëve të huaj të regjistruar është i kufizuar për shkak se programet e ciklit të parë dhe të dytë ofrohen në gjuhën shqipe. Studentët e huaj vijnë nga vendet fqinje, si Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia. Disa studentë të doktoraturës janë nga Turqia. Për sa i takon mobilitetit të studentëve, një numër studentësh ndërkombëtarë kanë ndjekur një semestër në Universitet, në kuadër të programit Erasmus. **[Dokumente 127, Tabela përmbledhëse e marrëveshjeve, dhe 128, Shkëmbimi ndërkombëtar Erasmus+)** Raporti staf-studentë në Universitet është në normën 1:20, duke përmbushur normat shtetërore. **[Kapitulli I Standardi III.4]**
- 5.3 Universiteti përdor një sërë metodash të komunikimit me studentët, duke përfshirë faqen e internetit, përdorimin e faqeve të mediave sociale, telefonin, postën elektronike, tutorialet dhe takimet e rregullta. Çdo student ka një llogari elektronike (UMIS), ku merr informacion të detajuar rreth kursit, leksioneve, orarit të kurseve, vlerësimit dhe provimeve. Dosjet e studentëve menaxhohen nga Zyra e Kontratave. **[Dokumente 129, Info. nga Zyra e TI-së]** Për më tepër, orari i punës për stafin akademik dhe administrativ publikohet në derën e zyrave. Adresa elektronike e secilit anëtar të stafit akademik është publikuar në faqen e internetit. Studentët pohuan se janë të kënaqur me rregullimin e orarit të punës së stafit dhe se gjithmonë mund të kontaktonin tutorët e tyre me anë të postës elektronike. Ata konfirmuan se “ka gjithmonë një person në dispozicion për të biseduar”. **[Mbledhja 2, Studentët e ciklit të parë] [Mbledhja 3, Studentët e ciklit të dytë dhe të tretë] [Mbledhja 5, Stafi akademik dhe kërkimor] [Mbledhja 4, Drejtuesit të lartë] [Kapitulli I Standardi III.2]**
- 5.4 Studentët kanë një Këshill efektiv dhe efikas studentor. Mbledhjet e hapura mbahen çdo muaj dhe përfaqësuesit e studentëve takohen rregullisht me Rektoratin. Mbledhjet e departamenteve mbahen çdo të martë, ku të gjithë studentët mund të marrin pjesë për të diskutuar lirisht për çështje të ndryshme. Pas çdo mbledhje, procesverbalet

publikohen në internet, zakonisht në të njëjtën ditë. Studentët konfirmuan se Universiteti reagon ndaj komenteve dhe mendimeve të tyre dhe bënte ndryshime. **[Mbledhja 2, Studentët e ciklit të parë] [Mbledhja 3, studentët e ciklit të dytë dhe të tretë] [Mbledhja 6, Stafi mbështetës]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i mendimit se stafi akademik dhe administrativ i marrin seriozisht mendimet e studentëve dhe reagojnë në varësi të këndvështrimeve të studentëve. Megjithatë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm mësoi se “vetëm studentët e shkëlqyer” përzgjidheshin për të marrë pjesë në takime, tryeza të rrumbullakëta dhe projekte të tjera të organizuar, ku mund të japin mendimet e tyre. **[Mbledhja 2]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm sugjeron që në të ardhmen grupet e fokusit ose tryezat e rrumbullakëta të përfshijnë më shumë studentë, për të marrë mendime që përfaqësojnë tërë trupin e studentëve. **[Kapitulli I Standardi III.7]**

5.5 Orientimi dhe procesi i mentorimit të studentëve fillon përpara regjistrimit dhe vazhdon edhe pas diplomimit të tyre. Shërbimet mbështetëse ofrohen nga disa struktura, të tilla si: Zyra e Pranimeve dhe Kujdesit ndaj Studentit; Zyra e Karrierës dhe Praktikës; Qendra e Këshillimit Akademik; ditët e këshillimit akademik dhe orientimit. **[Dokumente 130/131/132, Urdhër i Rektorit/Rregullorja, Neni 38/Seanca metodologjike]** Studentët përshtaten me jetën e Universitetit gjatë ciklit të parë të studimeve dhe secili prej tyre ka mundësi të ndryshojë studimet në përputhje me rregulloret e Universitetit. **[Dokumente 133, Statuti, neni 26]** Studentët janë të mendimit se informacioni i dhënë gjatë fazës së orientimit ishte i detajuar dhe i kuptueshëm. Sekretaria e fakultetit shpjegon secilin program të fakultetit, e më pas Dekani i Fakultetit jep shpjegime në lidhje me programin e studimit. **[Mbledhja 2, Studentët e ciklit të parë] [Mbledhja 3, Studentët e ciklit të dytë dhe të tretë]** Zyra e Karrierës dhe Praktikave jep këshilla për karrierën, organizon praktika dhe Panairët vjetore të punës, dhe mban lidhjet me të diplomuarit **[RVV, fq.31]** Njësia e shërbimit të aftësisë së kufizuar ofron mbështetje për personat me aftësi të kufizuara, **[RVV, fq. 32]** si për shembull duke mbështetur një student të verbër **[Mbledhja 2, Studentët e padiplomuar]** dhe Klinika Psikologjike ofron mbështetje emocionale. **[Dokumente 66, Urdhri i Rektorit Nr.12; Mbledhja 6, Stafi Mbështetës]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjykon se qasja e diferencuar dhe gjithëpërfshirëse për mbështetjen e studentëve, duke përfshirë kërkesat fillestare të programit, tutorialet, zhvillimin e karrierës, kujdesin ndaj aftësisë së kufizuar dhe mbështetja emocionale janë tipar i **praktikës së mirë. [Kapitulli I Standardi III.3]**

5.6 Universiteti ofron një numër bursash, si ekselencia, lidhshipi, promovimi social dhe talenti. **[Dokumente 134, Të dhënat mbi shpërndarjen e bursave]** Bursat sociale ofrohen për studentët me aftësi të kufizuara, për studentët nga komunitetet romë dhe egjiptiane, fëmijët e policëve [të rënë në krye të detyrës] dhe studentët që vijnë nga rrethana të vështira akademike. **[Dokumente 135 & 136, politika e shpërndarjes/poster i bursave]** Universiteti ka hartuar Rregulloren për studentët me aftësi të kufizuara, e cila përfshin standarde të përgjithshme të mbështetjes ndaj studentëve me aftësi të kufizuara mendore dhe fizike. Rregullorja i referohet nenit 57 të Kushtetutës së Shqipërisë, i cili përcakton se “kushdo gëzon të drejtën e arsimit”. Këtu përfshihen personat tek të cilët kufizimet e aftësisë fizike, mendore ose shëndetit psikologjik ka të ngjarë të zgjasin më shumë se gjashtë muaj nga fillimi i gjendjes mendore ose fizike. **[Dokumente 137, të dhënat nga Zyra e Kujdesit ndaj Studentit]**

& AE-50] Në mënyrë që të marrin bursën e ekselencës, studentët duhet të kenë rezultate të mira gjatë gjithë studimeve të tyre në Universitet. **[Mbledhja 4, Stafi i lartë drejtues]** Universiteti cakton 13 për qind të buxhetit të tij vjetor për bursa, duke përfshirë mbështetjen për studentët egjiptianë, romë dhe shqiptarë. **[Mbledhja 4, Stafi i lartë drejtues]** Gjatë takimeve me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm, studentët folën shumë mirë për programin e bursave dhe ishin në dijeni të tij dhe ishin shumë të qartë për mënyrën e aplikimit që para regjistrimit në Universitet. **[Mbledhja 2, Studentët e ciklit të parë]** **[Mbledhja 3, studentët e ciklit të dytë dhe të tretë]** **[Mbledhja 5, Stafi akademik dhe kërkimor]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konsideron se gama e bursave në dispozicion të studentëve janë një **praktikë e mirë.** **[Kapitulli I Standardi III.4]**

- 5.7 Në lidhje me studentët me aftësi të kufizuara, Universiteti ka bërë përpjekje të mëdha për të mbështetur studentët me aftësi të kufizuara, si për paaftësinë e dukshme, ashtu edhe të padukshme. Studentët me atësi të kufizuar në të parë mbështeten, duke iu vënë në dispozicion tekste në alfabetin Braille. Gjithashtu, Universiteti ka punësuar një psikolog me kohë të plotë për ata që kanë nevojë. Megjithatë, Universiteti pranon se jo të gjitha katet në të gjitha ndërtesat janë të aksesueshme nga studentët me vështirësi në lëvizje. Universiteti synon të zgjidhë këtë problem, duke ndërtuar një kampus tërësisht të ri. **[Mbledhja 2, Studentët e ciklit të parë]** **[Mbledhja 3, studentët e ciklit të dytë dhe tretë]** **[Mbledhja 6, Stafi mbështetës]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon veprimet e kryera tashmë nga Universiteti dhe e nxit atë të vazhdojë të zhvillojë strategjinë e tij në mbështetje të studentëve “në nevojë”, me aftësi të kufizuara të dukshme dhe të padukshme. **[Kapitulli I Standardi III.4]**
- 5.8 Universiteti ofron mbështetje për gjetjen e literaturës me anë të bibliotekës. Gjithashtu, materiale jepen nga stafi akademik, shtëpia botuese dhe libraria. Biblioteka ka 5,626 tituj librash dhe 155 revista, një pjesë e të cilave janë në anglisht. **[Dokumente 138, Inventari i Bibliotekës]** Gjithashtu në dispozicion janë një numër bibliotekash online të cilat klasifikohen sipas secilit fakultet. Biblioteka është e hapur nga ora 9:00 -20:00, nga e Hëna në të Premte dhe nga ora 9:00-17:00 të shtunave. **[Dokumente 139, Faqet e internetit të bibliotekave]** Studentët pohuan se kishin qasje në burime të printuara dhe në format elektronik. Orari i hapjes së bibliotekës konsiderohej si i arsyeshëm; hapësira dhe mjedisi i punës u konsideruan të mira. Gjithashtu, Biblioteka kishte kompjuterë të lidhur me internet. **[Mbledhja 2, Studentët e ciklit të parë]** **[Mbledhja 3, studentët e ciklit të dytë dhe tretë]** **[Mbledhja 5, Stafi akademik dhe kërkimor]** **[Kapitulli I Standardi III.5]**
- 5.9 Gjatë gjithë vitit akademik ofrohet monitorim pedagogjik. Universiteti këshillon që secili student të mbajë të njëjtin lektor gjatë gjithë ciklit të studimeve. **[Dokumente 140, Rregullorja neni 38]** Studimet akademike mbështeten si nga stafi akademik, ashtu edhe nga stafi i bibliotekës, për sa i takon shkrimin akademik dhe metodave të kërkimit. Studentët që kanë vështirësi kanë mundësinë e zhvillimit të orëve të mbështetjes profesionale **[Dokumente 141, Të dhëna për zyrën e sekretarisë]** Stafi akademik është i disponueshëm çdo të premte në orën 3-5 pasdite, për t’iu dhënë përgjigje shqetësimeve akademike të studentëve. Përfaqësuesit e grupeve gjithashtu mund të ngrenë çështje në emër të studentëve. U konfirmua se çështjet në përgjithësi zgjidheshin shumë shpejt. **[Mbledhja 2, Studentët e ciklit të parë]** Përveç kësaj, Dekani i Studentëve është në dispozicion të studentëve në çdo kohë, nëse ata kanë

probleme apo çështje të veçanta. **[Mbledhja 4, Stafi i lartë drejtues] [Kapitulli I Standardi III.6]**

- 5.10 Studentët nxiten të marrin pjesë në organet përfaqësuese të Universitetit dhe ato vendimmarrëse; pritet që studentët të shprehin mendimet e tyre. Rektori takohet rregullisht me studentët, për të diskutuar çështje interesante dhe të veçanta. **[Dokumente 142 Statuti neni 34] [Mbledhja 1, Rektori]** Studentët përfaqësohen në një sërë komisionesh brenda Universitetit, të tillë si: Këshilli Studentor, Senati Akademik, Këshilli i Etikës, Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe takimet e hapura të Departamentit. Universiteti mbështet Këshillin e Studentëve, dhe financon projekte, duke përfshirë gazetën e studentëve. **[Dokumenti 143/144/145/146 Statuti, nenet 19]** Studentët u angazhuan plotësisht në zhvillimin e Raportit të Vetëvlerësimit dhe dhanë kontribute të dobishme dhe reflektuese për grupin. **[Mbledhja 0, Grupi i hartimit të RVV]** Studentët konfirmuan se plotësojnë një anketim anonim online çdo semestër. Studentët me vështirësi në shikim i përgjigjen një anketimi me gojë. Në lidhje me rezultatet e anketimeve, studentët konfirmuan se Përgjegjësi i Departamentit merr seriozisht çdo çështje dhe se të gjithë studentët merrnin një përmbledhje të veprimeve të ndërmarra. **[Mbledhja 2, Studentët e ciklit të parë] [Mbledhja 3, studentët e ciklit të dytë dhe të tretë] [Kapitulli I Standardi III.7] [ESG 1.3 Të nxënit me në qendër studentin, mësime dhe vlerësimi]**
- 5.11 Studentët marrin ndihmesë për arritjet e tyre personale, sociale dhe akademike përmes Dekanit të Studentëve dhe Zyrës së Pranimeve dhe Kujdesit ndaj Studentit. Studentët kanë mundësi të marrin pjesë në një sërë klubesh për studentët, duke filluar nga veprimtaritë artistike, kulturore e deri tek ato akademike. **[Dokumente 147, Faqja e internetit, aktivitete dhe klube]** Studentët konfirmuan se ishin aktivë në klubet e studentëve për futbollin, basketbollin, grupin e avokatëve dhe klubin e risive të TI-së. Për më tepër, studentët organizonin tryeza të rrumbullakëta, fokus grupe, folës të ftuar dhe simulim debati. **[Mbledhja 2, Studentët e ciklit të parë] [Mbledhja 3, studentët e ciklit të dytë dhe të tretë] [Mbledhja 6, Stafi mbështetës]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përgëzon Universitetin, i cili siguron që studentët të jenë të përfaqësuar brenda Universitetit dhe që zëri i tyre të dëgjohet nga përfaqësuesit e tyre në komitetet kyç, të marrin pjesë në këshillat studentorë, të marrin pjesë rregullisht në anketime dhe të përfshihen në klube dhe shoqata. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm konsideron që këto aspekte përbëjnë aspekte të **praktikës së mirë**. **[Kapitulli I Standardi III.8]**
- 5.12 Studentët e Universitetit punësohen ose kryejnë praktikat pranë një numri të madh kompanish dhe institucionesh të rëndësishme në mbarë Shqipërinë. **[Dokumente 148, Të dhënat nga Zyra e Pranimeve dhe Kujdesit ndaj Studentit/Alumni]** Universiteti kryen një numër aktivitete që synojnë nxitjen e punësimit të studentëve, duke përfshirë Bordin e Tregut të Punës, i cili synon të forcojë karakterin profesional të të gjitha programeve; Panairin e Punës, i cili zhvillohet çdo vit me pjesëmarrjen e 60 kompanive **[25% e studentëve që marrin pjesë punësohen nga kompanitë pjesëmarrëse]** dhe Forumi i Biznesit, i cili synon të mbështesë bashkëpunimin e Universitetit me komunitetin e biznesit, për të krijuar mundësi punësimi për studentët pas diplomimit. **[Dokumente 149] [Mbledhja 1 Rektori] [Mbledhja 5 me stafin akademik dhe kërkimor]** Studentët i thanë Grupit të Vlerësimit të Jashtëm se ndiheshin të mbështetur në kërkimin e punësimit. Çdo departament ka një “profesor të

karrierës”, i cili përkrah ambiciet e karrierës. Zyra e Karrierës ofron mbështetje shtesë. **[Mbledhja 2, Studentët e ciklit të parë] [Mbledhja 3, studentët e ciklit të dytë dhe të tretë]** Pranë çdo departamenti vepron një bord i tregut të punës, i përbërë nga 10 përfaqësues të jashtëm. Bordi i kushton rëndësi përshtatshmërisë së programeve të studimit në lidhje me punësimin. **[Mbledhja 4, Stafi i lartë drejtues] [Mbledhja 6, Stafi mbështetës]** Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjykon se mbështetja e studentëve për të gjetur punë, duke përfshirë Bordet e Punës, gamën e praktikave, Panairin vjetor të Punës, Forumin e Biznesit dhe udhëzimin dhe orientimin e karrierës, janë një **praktikë e mirë**. Megjithatë, Universiteti mund të përmirësojë mbështetjen që ai iu ofron të diplomuarve, duke analizuar më mirë të dhënat për ta. Kjo u identifikua nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm si **dobësi**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm **rekomandon** që mbledhja e të dhënave statistikore mbi punësimin e të diplomuarve (gjë që është në një fazë të hershme zhvillimi) të evoluojë në një strategji dhe proces të qartë për mbledhjen e këtyre të dhënave, në mënyrë që të mbështetet zhvillimi i programeve studimore të Universitetit dhe Shoqatës Alumni. **[Kapitulli I Standardi III.9] [ESG 1.7 Menaxhimi i informacionit]**

5.13 Përgjegjësitë për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përcaktuar qartë në Statutin dhe Rregulloret e Universitetit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi si praktikë të mirë qasjen e diferencuar dhe gjithëpërfshirëse të mbështetjes së studentëve, morinë e mbështetjes në lidhje me punësimin e studentëve, sigurimin e një numri të madh bursash dhe përfaqësimin aktiv të zërit të studentëve brenda Universitetit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi si dobësi analizën e të dhënave të punësimin të të diplomuarve. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm rekomandon që Universiteti të zhvillojë një strategji dhe një proces të qartë për mbledhjen e të dhënave të punësimin të të diplomuarve, për të mbështetur zhvillimin e programeve studimore të Universitetit dhe Shoqatës Alumni.

Gjetjet

Praktikë e mirë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- qasja e diferencuar dhe gjithëpërfshirëse në mbështetje të studentëve, duke përfshirë kërkesat fillestare të programit, tutorialet, zhvillimin e karrierës, kujdesin për personat me aftësi të kufizuara dhe mbështetjen emocionale (pika 5.5)
- gama e bursave në dispozicion të studentëve (pika 5.6)
- përfaqësimi i zërit të studentëve në jetën institucionale të Universitetit, përfshirë: përfaqësimin në komitetet kyçe, pjesëmarrjen në këshillat e studentëve, përdorimin e anketimit të studentëve dhe angazhimi në klube dhe shoqata (pika 5.11)
- dhënia e ndihmesës për të gjetur punësim për studentët, përfshirë praktikën, Panairin vjetor të punës, Forumin e Biznesit dhe udhëzimin për karrierën (pika 5.12).

Dobësi

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësinë e mëposhtme:

- analiza e të dhënave të punësimit të të diplomuarve (pika 5.12).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- zhvillimi i një strategjie dhe procesi të qartë për mbledhjen e të dhënave të punësimit të të diplomuarve, për të mbështetur zhvillimin e programeve të studimit të Universitetit dhe Shoqatës Alumni (pika 5.12).

Pohim i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi ndonjë veprim në proces në lidhje me këtë Fushë Vlerësimi.

Gjykimi

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e tyre janë përmbushur kryesisht.